



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec




01 Nr. 07/22
Rahovec, 20.07.2022

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen shtatë (7) e cila do të mbahet më **29 korrik 2022 (e premte)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i Raportit financiar janar – qershor – 2022;
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së DKA-së për përfundimin e vitit mësimor 2021/2022;
5. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Rahovecit për vitin 2021;


KRYESUESI I KUVENDIT
Defrim Kafexhiu





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e gjashtë (6) e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.06.2022**, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i kuvendit z. **Defrim Kafexhiu**. Konstatohet se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes, i nderuar kryetar i komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm.

Të nderuar kuvendarë për këtë mbledhje sot, propozojmë këtë :

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00369-0 zonë kadastrale Mrasor;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00759-0 në zonën kadastrale Retijë;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00377K-0, 00444K-0 dhe 02214K-0 në zonën kadastrale Xërxë;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik – P- 01830-0, zona kadastrale Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P - 01830-0, zona kadastrale Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik – P- 01043-1, 01035-0, 01039-0 dhe 01036-2, zona kadastrale Xërxë;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 01043-1, 01035-0, 01039-0 dhe 01036-2, zona kadastrale Xërxë;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025 dhe Qarkores Buxhetore 2023/1;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës personave fizik dhe juridik – P-01038-2, 01055-2, 01034-0, 01045-0, 01033-2, 01044-0, 01040-0, 01036-2, zona kadastrale Xërxë;

12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-01038-2, 01055-2, 01034-0, 01045-0, 01033-2, 01044-0, 01040-0, 01036-2, zona kadastrale Xërxe;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publike;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr. 306/22 i datës 29.04.2022 për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve në komunën e Rahovecit i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin 01-Nr. 334/22 të datës 31.05.2022;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 333/22 i datës 31.05.2022 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71513005-02756-0 në Zonën kadastrale Krushë e Madhe
16. Informatë nga drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;

Pikat shtesë

17. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit nr.332/22 i datës 31.05.2022 për caktimin e lokacionit për hapësira për biznese;
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për ndërrimin e akronimit nga SHMLP “Selajdin Mullaabazi-Mici” në IAAP “Selajdin Mullaabazi-Mici” në Rahovec;
19. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit nr. 329-22 për ndryshimin e vendimit 296-22 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël;
20. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël;

Kryesuesi – E ftoj sponsorizuesin e atyre dy pikave që duhet të shfuqizohen drejtorin Erhan Morina, për zonën kadastrale Krushë e Madhe, ose fjalën e ka Afrim Oruqi për prezantimin e dy shfuqizimeve.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të kuvendit, propozoj që të tërheqim pikën me nr. 5 nga rendi i ditës; Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00377K-0, 00444K-0 dhe 02214K-0 në zonën kadastrale Xërxe, me arsyetimin që këto parcela gjinden në zonën e komasacionit dhe sipas planit zhvillimor komunal në fuqi të vitit 2013 këto zona nuk parashihen si zona ndërtimore, për këtë arsye ne kemi brenda kësaj periudhe ne kemi ndryshim të legjislacionit në fuqi që eventualisht këto pika të rikthehen si të kundërligjshme prej MAPL-së, jemi në fazën përfundimtare të përgatitjes së planit zhvillimor të ri komunal dhe këto parcela që po flasim në këto momente janë të parapara në planin e ri zhvillimor komunal në komunën e Rahovecit si zona ndërtimore. Pas kalimit të planit zhvillimor komunal i komunës së Rahovecit ne do t'i rikthejmë këto zona në seancat e radhës, kërkoj nga ju që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

Kryetari – Përshëndetje për kryesuesin e kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit, media, drejtorë të drejtorive, nënkryetarin; diçka rreth pikës që ka të bëjë me caktimin e lokacionit për nevojat e ndërtimit të morgut në Hoçë të Vogël, departamenti ligjor i ministrisë së pushtetit lokal ka kërkuar rishqyrtim të vendimit dhe propozoj që ne ta anulojmë vendimit dhe ta nxjerrim një vendim të ri, pra

një pikë të re të rendit të ditës ku 60% që nuk është i paraparë me planin e vjetër zhvillimor komunal, ose është paraparë si tokë bujqësore dhe vendimi i ri të përmbajë vetëm 40% tokë ndërtimore, në fakt aty është ndërtuar morgu. Nuk e di sa jam i qartë, 60% që është tokë bujqësore, ata na kanë kthyer për rishqyrtim, ne e heqim tash 60%-in, e bëjmë një vendim të ri duke e shfuqizuar këtë dhe e vendosim si pikë të re të rendit të ditës, ku më së largu nesër ne ia dërgojmë ministrisë së pushtetit lokal vendimin e ri ku përfshihet vetëm 40% që është tokë ndërtimore. Në qoftëse jeni dakord si pikë e rendit të ditës të përfshihet, propozimi për miratimin e vendimit për caktimin e lokacionit për nevojat e ndërtimit të morgut në Hoçë të Vogël në sipërfaqe sipas PZHK-së që 40% është paraparë si tokë ndërtimore. E ftoj drejtorin e kadastrës që ta bie një skicë ku tregon rreth 40% ku është tokë ndërtimore për nevojat e saktësimit të vendimit të ri që pritet të miratohet prej anëtarëve të kuvendit të komunës.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, atëherë shkak për vendosjen e pikave shtesë për seancën e sotme në rend dite është që sipas LVL kuvendi i komunës është i obliguar që të rishqyrtoj vendimet e kthyer nga autoriteti mbikëqyrës për një periudhë 30 ditëshe, kështu që te pika e 20, është shfuqizimi i vendimit nr.329 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut dhe po e shtojmë edhe pikën 21, vendimi i ri për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël. Kështu, pikat shtesë po i vendosi në votim, janë gjithsej 5... kush është për?...Atëherë me shumicë votash aprovohet shtimi i 5 pikave tjera në rendi dite. Drejtori i kadastrës si sponsorizues i pikës së 5-të e tërhoqi këtë pikë, rendi i ditës tani gjithsej i ka 20 pika. Atëherë si të tillë e vendosim në votim miratimin e rendit të ditës; kush është për?...kundër?...abstenim?... Me 22 vota për miratohet rendi i ditës për ditën e sotshme, po vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës;

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, kryetar, të pranishëm, unë e kam vetëm një kërkesë, është hera e dytë që na vijnë vendimet për shfuqizim, mendoj që është e udhës që vendimet që vijnë për shfuqizim të shoqërohen me materiale mbi bazën e arsyes së kërkuar për shfuqizim. Unë e kuptoj që kryetari ose drejtori ndoshta edhe kryesuesi e kanë informatën, por duhet ta ketë secili asamblistë informatën e plotë për çfarë arsye është kthyer nga MAPL-ja vendimi sepse ne përsëri duhet ta votojmë për shfuqizim dhe për vendim të ri, le të praktikohet që kur një vendim të shfuqizohet të jepet arsyetimi i shfuqizimit të vendimit, asgjë më tepër, besoj që është e drejtë e të gjithë delegatëve të asamblesë ta kenë këtë informatë.

Besë Bytyqi – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë këshilltarë, drejtorë të drejtorive, në emër të grupit të aleancës kërkoj një minutë heshtje në seancë të kuvendit komunal, me rastin e ndarjes nga jeta të poetit tonë Xhevdet Bajraj, një poet i njohur ndërkombëtarisht e meriton këtë lloj respekti.

Kryesuesi - Faleminderit Besë, atëherë ju ftoj të gjithëve të ngitemi në këmbë dhe një shenjë respekti të mbajmë një minutë heshtje... lavdi jetës dhe veprës së poetit Xhevdet Bajraj. Atëherë jemi te pika e parë e rendit të ditës;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; a ka dikush ndonjë koment lidhur me procesverbalin?...Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për miratimin e procesverbalit?...Me shumicë unanime aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Vazhdojmë;

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Fillimisht jam në dijeni për raportin e auditimit, për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Rahovecit të vitit 2021 dhe jam në dijeni që është nxjerrë vlerësimi zyrtar me datën 06.06.2022 dhe është pranuar nga zyra e kryetarit me

datë 09.06.2022. Pyetja ime kish me qenë për kryetarin se kur dëshiron të na prezantoj këtë raport gjeneral të auditimi të jashtëm. Tjetër, e kam një shqetësim unë, në seancën e kaluar, kolegu im Leonard Morina ka kritikuar drejtorinë e arsimit të komunës së Rahovecit, ku në formën e vet është munduar t'i prezantoj disa prova juridike ku ka shkelje të vazhdueshme dhe pas një pauze aty jashtë, për koincidencë isha afër drejtorit i cili i thotë kolegut Arbër Zenuni; po e citoj; ishte në mënyrë arrogante që mua më pengon shumë "duhet me ma gjetë një mësimdhënës t'a zëvendësoj Leonard Morinën, unë duhet me maru një prej lloqit, me hek Leonard Morinën- me shti atë t'lloqit" kjo qasje është gabim për vlerësimin tim, jo për Leonard Morinën, por për të gjithë këtu në sallë dhe të gjithë banorët e komunës sonë. Unë para vetës kam një aktgjykim, meqë jam jurist flas vetëm me fakte. Aktgjykimi është nxjerrë me datën 05.04.2022 në gjykatën themelore në Gjakovë dega në Rahovec ku e paditur është komuna e Rahovecit, konkretisht DKA-ja. Një mësimdhënës për të cilin e përcakton ligji për ta bërë plotësim-ndryshimin e normës mësimore, e ku ai i gjori anashkalohet sepse nuk ka ndonjë fuqi kështu (se si po shkojnë gjërat këtu te ne) dhe e marrin një tjetër, ndihem shumë mirë që kanë filluar me u marrë me ligjin dhe të jeni në dijeni që DKA-ja nuk është pronë private, por publike dhe interesant është këtu, me këtë aktgjykimin që është nxjerrë me 05.04.2022 thotë; aprovohet kërkesë padia si bazuar, në këtë rast detyrohet DKA-ja dhe shpenzimet procedurale për këto "salltet" që i bënë janë 644euro dhe janë taksa të mia personale dhe është interesant që përfaqësuesi ligjor i DKA-së, po mundohet ta citoj, uroj me qenë gabim teknik, thotë kështu; Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në këtë rast komunës konkretisht DKA-së, gjatë shqyrtimit kryesore dhe fjalës së tij përfundimtare ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesë padinë e paditësit, në këtë rast të arsimit. Këtu mendoj që duhet thënë që e kundërshtoj në tërësi dhe të jipen faktet pse kundërshtohet. Në arsyetimin e tij në përgjigje, përfaqësuesi ligjor thotë; Për shkak se paditësi nuk i ka shterrur të gjitha mjetet ligjore, andaj e konsideron që gjykata tani për tani nuk mund të shqyrtoj një padi që ka elemente "kot fare". Nëse ky përfaqësuesi ligjor që është avokat privat edhe nuk e kundërshton po e konteston. Ta pyes sinqerisht kryetari, "Allahu na ruajt, me na gjet naj sen drejtorin" çka bëjmë ne? sepse ky me një farë mënyre i pazëvendësueshëm!!

Kryetari - Zyra kombëtare e auditimit e ka raportin publik të publikuar, besoj që në korrik si zakonisht çdo vit është fut në rend dite edhe kësaj radhe futet në korrik. Nuk ka nevojë as për "sallta" e as për "filma" sepse është raport publik. Ju siguroj që ballafaqimeve, nevojave për sqarime dhe argumentime jemi këtu për shpjegim dhe nëse dikush dëshiron ta shfrytëzon për tjetër gjë, duhet të jetë në dijeni që ne jemi të zgjedhur të komunës së Rahovecit. Pastaj duhet të kem parasysh që ne nuk jemi këtu në sallë të gjyqimit askush nuk është gjyqtarë e as prokurorë. Ne kemi kapacitete, kemi përfaqësimin ligjorë, kemi avokatin e komunës poashtu kemi një marrëdhënie kontraktuale me avokat që mbronë interesat e komunës së Rahovecit dhe besoj që kjo pikë e rendit të ditës nuk është mirë të keqkuptohet, fola pak edhe me kryesuesit me respekt, ne bëjmë pyetje, komente, këshilla, rekomandime, kritika, plotësime por jo të filozofojmë shumë dhe t'ia ndërrojmë dimensionin pikës së rendit të ditës. Nuk ka përgjigje nga DKA sot, përgjigjet në seancën tjetër, ndërsa për raportin e ZKA-së përgjigjen e keni të qartë, në korrik futet në rend dite, jemi të obliguar.

Sinan Kryeziu – Unë duhet me qenë korrekt, me veten dhe juve e sidomos me kryetarin, nuk i thash kryetarit me bë "sallta" përkundrazi i thash zyrës së DKA-së, këtu ka keqpërdorim të detyrës zyrtare që sanksionohet me ligj. Nuk pajtohem unë për qejfe të dikujt, që taksat e mia vetëm procedurë gjyqësore t'i paguajmë 644 euro, për një lëshim të drejtorisë, nuk thash për raportin e auditorit, por për drejtori kjo është shumë serioze.

Kryetari – Tash prej këtu po sqaroj, nuk po replikoj. Nuk thash që unë po bëjë “sallta” po bën ti!...Dëgjo, nuk je ti organ që gjykon, ose vendos për drejtorinë. Kemi instancat gjyqësore që vendosin për cilindo, ka një vendim të shkallës së parë, ka të drejtë për ankimim, ndërsa kush është organi që merret me trajtimin e çështjeve që ti i paraqet, unë që ti je jurist edhe i din. Nëse ti mendon që duhet të sakrifikoj diçka, nuk ta jap atë kënaqësi as ty as askujt, sepse ky është drejtor i drejtorisë së arsimit i emëruar prej kryetarit dhe përfaqëson konceptin dhe vizionin e kryetarit të komunës dhe punën e tij e bazon në ligje dhe udhëzime administrative, në çoftëse ky ka bërë shkelje, nuk jam unë si asambleist që mund të vendosi për të. A ka bërë mirë, apo keq ti mund të thuash çkado që dëshiron, mirëpo vlerësimet përfundimtare e merr dikush tjetër.

Bejtullah Deliu – Faleminderit i nderuar kryesues, kryetar, zv. kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, media dhe ju të pranishëm. Rastësisht nëpër rrjete sociale dhe e pashë në postim nga ministria e bujqësisë që gjatë muajit prill dhe maj kanë aplikuar 15 komuna për një grant për ujitje, nga këto 15 komuna 8 prej tyre janë përfituese. Komuna e Rahovecit shquhet apo krenohemi që jemi kryeqytet i bujqësisë e këtu nuk jemi përfitues dhe kjo më shqetëson nga fakti ku jep sqarim ministria thotë; vlen të theksohet se pas shkresës e cila i është drejtuar të gjitha komunave dhe drejtorive respektive për bujqësi të vendit në fund të muajit prill dhe fillim të muajit maj në adresë të bujqësisë kanë ardhur 15 projekte për sistemin e ujitjes nga këto janë 8 përfituese, dëshiroj një sqarim nga drejtori i bujqësisë apo edhe nga ju kryetar, nëse ne kemi dështuar në këtë projekt duhet të jep dikush përgjegjësi, por nëse ministria për shkaqe personale apo që më herët është kritikuar që ministri nuk vjen për vizitë te ne e shkon direkt në terren, mendoj që pozitë e opozitë duhet të reagojmë këtu dhe nga ministria të kërkojmë që komunën tonë ta përfshij sidomos në këto projekte, nuk dua të fajësoj as drejtorinë për moment pa i dëgjuar faktet, por nëse ne si komunë kemi dështuar për një projekt të tillë, atëherë është çështje serioze dhe të jepet përgjegjësi nga dikush, nëse prapë e citoj për shkaqe banale ministria e ka eliminuar Rahovecin për këtë projekt, ju ftoj pozitë e opozitë për reagim, me konferencë për media dhe me të gjitha mundësitë për presion sepse për këto projekte Rahovecit duhet të jetë komuna e parë përfituese. Në arsyetim të dytë, rreth akuzës së kolegut nëse me të vërtetë ajo bisedë mes drejtorit dhe asamblistit ka ndodhë, është vërtetë pak shqetësuese. Nëse kryetari e arsyeton drejtorin që ky drejtor është i zgjedhur dhe i ndjek politikat e kryetarit, uroj që politikat e kryetarit mos t'i ketë.

Kryetari – Bejtullah, ne nuk kemi aplikuar për zgjerim të sistemit të ujitjes për shkak që nuk kemi të drejtë, sepse KRU-Gjakova është aplikuese dhe është e përfshirë në një projekt të bankës botërore, rehabilitimi i sistemit aktual të ujitjes dhe zgjerimi i këtij sistemi, pra aplikacionet në këtë rast shkojnë përmes KRU-Gjakovës dhe ne si komunë deri në fund të 2022 nuk kemi të drejtë aplikimi në projekte të tilla, ndërsa në projekte të cilat ministria e bujqësisë ka bërë thirrjen, kanë të bëjnë me burime alternative dhe kanale të hapura të cilat ne nuk kemi mundësi t'i zhvillojmë për shkak të këtij projekti të madh të bankës botërore, rehabilitim dhe zgjerim kjo është arsyeja dhe arsye tjetër nuk ka sepse nuk kemi të drejtë aplikimi deri në 2023. Sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me relacionet e komunës së Rahovecit me ministrinë e bujqësisë, në asnjëherë nuk e kemi kontestuar faktin që prodhon nevojën për relacione e bashkëpunim midis nivelit lokal dhe qendror të drejtorisë sonë të bujqësisë dhe ministrisë në anën tjetër dhe kjo është duke ndodhur, faktikisht jemi komunal që ka 2976 aplikues për subvencione dhe ne shqetësimet të cilat i kemi ngritur p.sh; kësaj radhe i kemi ngritur për çështje të noterit, ka mund të tingëllojë jo mirë për ata të ministrisë, por besoj që së shpejti do ta vizitoj edhe komunën e Rahovecit dhe do të diskutojmë tema që janë në nevojë për komunën e

Rahovecit për grante, subvencionim të verëtarëve, vreshtarëve – i kemi ngritur këto tema edhe me kryeministrin që ishim në Prevallë, me ministrin e Financave dhe besoj që nuk ka arsye askush të bëhet nervoz e as ministri i bujqësisë në këtë rast sepse është e vërtetë që mundet me qenë më fleksibil për shkak se komuna jonë e ka vulën e një treve bujqësore në krahasim me komunat që janë më pak bujqësore, sidoqoftë ai po vepron mirë që po shkon nëpër komuna tjera edhe në komunën tonë shpresoj që shpejt do ta kemi dhe do ta kemi një situatë të qartë eventualisht ndonjë keqkuptim që e ka pas, unë nuk kam keqkuptime, kam ngritur interesa dhe shqetësime të qytetarëve dhe do t'i ngrisë prapë, nga kjo foltore edhe në emër të juajin e kam ngritur çështjen e mungesës së noterit sepse jemi ndër 15 komunat që nuk kemi ende noter edhe në takimin në Prevallë që ishim me kryeministrin edhe me ministrin e drejtësisë që duhet të bëjmë në zgjidhje sa më të shpejtë që noterët e Prizrenit t'i vendosin selitë e veta këtu, secili qytetarë ka nevojë për noter, jo vetëm fermeri. Besoj që ministri i bujqësisë z.Faton Peci shumë shpejt do të jetë në Rahovec, për shumë çështje që ka nevojë treva jonë dhe e ka prioritet bujqësinë, për më shumë të sheh nga afër se çka e mundon bujkun tonë dhe cilat janë sfidat e produkteve tona që i kemi sot të gatshme etj etj. Ne e kemi një projekt përveç depos për magazinim e kemi edhe një projekt të madh, në çoftëse na ndihmon do t'ia prezantojmë sepse jemi të përgatitur në fushë të fakteve dhe argumenteve për nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe bujqve të komunës së Rahovecit. Nuk marr përsipër çka ka thënë drejtori, as drejtori as kryetari i komunës dhe asnjëri nga ju nuk përfaqëson konceptin e një klime të acaruar me elemente fyese dhe nuk marr përsipër çka bisedohet nëpër korridore, njerëz jemi edhe mund të themi diçka edhe në afekt.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, po reduktohem pak prej përshëndetjeve mos të marr shumë kohë. Prej drejtorisë së urbanizmit tash në seancë mora përgjigjen rreth pyetjes se a duhet të kenë pranim teknik, d.m.th që po, çdo objekt pas përfundimit duhet të ketë pranim teknik nga investitori. Shpresoj drejtor që tani e tutje do të aplikohet kjo, me një komision profesional të ta bëni pranimin teknik të objekteve që investon komuna pavarësisht të kaluarës, sepse kryetari në seancën e kaluar tha që me raportin përfundimtar për herën e fundit e kemi bërë si pranim teknik. E dyta, një shqetësim që e kam, kryetar dhe drejtoreshë e inspektionit, sipas një konkursi që është shpallur për inspektor ndërtimi, fillimisht si konkurs të brendshëm por që nuk ka pasur aplikantë pastaj si konkurs të jashtëm, keni pranuar një inspektor të ndërtimit, sa e di unë inspektori në fjalë nuk e ka kualifikimin e inxhinierit të ndërtimit, përveç që në konkursit e dytë të jashtëm thuhet; specialist i inxhinierisë së ndërtimit-pozicioni inspektor ndërtimi. Është edhe një konkurs tjetër diku në komunë që prapë është kërkuar specialist i inxhinierisë së ndërtimit, nuk dua t'i përmendi emrat sepse është çështje konfidenciale e atyre përfituesve të konkursit, sa e di unë asnjëherë prej tyre nuk është inxhinier i ndërtimtarisë, si e tillë nuk besoj që guxohet të veprohet kështu, që kur kërkohet specialist i ndërtimit e të punësohet me profesion tjetër, sikur të ishte konkursi; kërkohet inspektor ndërtimi me këto kualifikime, inxhinier ndërtimi, jurist, ekonomist etj etj... blla blla blla 15/16 profesione qysh e dimë ndonjëherë për ta rregulluar konkursin, e kuptoj... po kur kërkohet specialist ndërtimi duhet me qenë patjetër inxhinier i ndërtimtarisë, nuk diskutohet ndryshe. Drejtoreshë, a mundet inspektori i ndërtimit i pakualifikuar si inxhinier të jetë i gatshëm të zbatoj ligjin për ndërtim 04/10 gjegjësisht nenin 31 kur thotë; secila fazë e ndërtimit është pjesë përbërëse e kërkesës të lëndëve ndërtimore dhe inspektimi realizohet pas përfundimit të secilës prej këtyre fazave në kuadër të zbatimit të kërkesave për lejen e ndërtimit. Paragrafi 2, inspektori verifikon përputhjen e punëve përfundimtare me dokumentacion ndërtimor dhe do të prodhoj protokoll mbi përfundimin e fazës respektive të ndërtimi i cili nënshkruhet nga përdoruesi i lejes, kontraktuesi dhe inspektori. Nuk po citoj nene tjera të këtij

ligji, si i tillë njëri prej inspektorëve që ka qenë prej fillimit e ka të kryer kriminalistikën pra nuk është inxhinier i ndërtimit por është inspektor që ka filluar punën prej vitit 2003 nëse nuk jam gabim që mund të vazhdoj punën e vet, por tash duhet të plotësohet ky inspektor me një profesionist tjetër. Besoj që duhet të keni kujdes dhe të rishikoni këtë konkurs edhe një herë, nuk po i kontestoj emrat, personale nuk e kam me askënd, por besoj që duhet të jemi të kujdesshëm. Meqenëse Përparimin nuk po e shoh këtu, te raporti i auditorit, një prej të gjeturave thotë që ka procedurë një burimore tenderuese, që është raport i kualifikuar për të cilën është pajtuar edhe menaxhmenti. Në anën tjetër në tenderin e fundit në e-prokurim ndërtimi i rrugëve lokale në komunën e Rahovecit Lot-3 thotë; procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, së paku që kur të vie një raport i auditimit, të gjeturat duhet të jemi më shumë të kujdesshëm që mos të përsëriten njësoj, po rekomandoj dhe besoj që keni me qenë më të kujdesshëm se një prej të gjeturave të prokurimit thotë që procedurat e negociuara si e gjetur jo e rregullt dhe menaxhmenti thotë po pajtohem. Pres që drejtori i urbanizmit të veproj sipas ligjit në të ardhmen dhe këto dy konkurse të rishikohen pa pas parasysh se kush janë ata dhe ky tender të jetë i hapur e jo i negociuar.

Kryetari – Po Burim, është e vërtetë që unë kam thënë që situacioni përfundimtar i shoqëruar me një raport nga menaxheri është fakti ose argumenti që e konsideron të përfunduar një projekt të caktuar. Ne kemi raste kur kemi pranime teknike, bie fjala për buste-shtatore, shkolla “Sadedin Hajda”, apo çerdhja e fëmijëve ka një standard që vepohet edhe kështu edhe ashtu, por ne kemi një rekomandim nga zyra lidhore dhe nga ekipi i USAID që ka punuar me ne, që në raportin përfundimtar të terrenit të projektit na jep mundësinë që ky projekt të jetë më i monitorueshëm, më i qëndrueshëm dhe është sepse organet që e kanë përcjellë projektin janë më të sigurte në vendimmarrje dhe më shumë mund të sigurojnë ata sesa një komision i cili nuk e ka përcjellë asnjë element të projektit dhe tash vjen veç e bënë një matje. Pra, ne këtë rekomandim e kemi zbatuar të USAID TIME dhe në vlerësime kemi dal shumë mirë, por kemi ende situata kur duhet edhe raport të komisionit të pranimi teknik. Pra komisioni i pranimi nuk është i dëmshëm, por më e qëndrueshme është kjo me situacion përfundimtar, Prishtina e aplikon këtë, ka komuna tjera që shkojnë me komisione të pranimi etj...Ne nuk mundemi mos me pas komision të pranimi teknik p.sh; për bustin e Skender Kastratit ose Murat Rexhepit ose për një shtatore tjetër. Por nuk mund të kemi komision të pranimi teknik p.sh. ia nisim një objekti ose shkolle pa e përcëlluar asnjë element gjatë ndërtimit, për përfundimit të punës t’i dërgojmë disa inxhinier (shkoni tash për një vërejtje sipërfaqësore)... Prandaj me USAID-in kemi diskutuar gjatë dhe na kanë rekomanduar kështu dhe ligjërisht është në rregull. Pra drejtori nuk ka bërë keq që t’a ka dhënë këtë përgjigje, por përgjigja më e plotë është kjo që po ta jap unë.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues, ekzekutiv, kolegë asamblistë. I kam dy pyetje për ekzekutivin. Rreth çështjes së rregullimit të rrugëve fushore në fshatin Hoçë e Vogël. E di që komuna nuk ka mundësi që t’i shtrojë të gjitha rrugët me asfalt, mirëpo së paku pengesat t’i largojë. Nuk e di a ka ndonjë plan rreth kësaj sezone për pastrimin e këtyre rrugëve fushore nga pengesat që këto rrugë i bëjnë të pakalueshme. Çështja tjetër është; një vendim të datës 14.07.2020 nga drejtoria e shërbimeve publike, kjo drejtori ka marrë një vendim nga drejtori Përparim Krasniqi me të cilin aprovohet kërkesa e z. Mustaf Elshani nga Brestoci 28.05.2020 në arsyetim thuhet; Drejtoria për shërbime publike duke shqyrtuar kërkesën e paraqitur dhe shkresat e lëndës, pas daljes në terren dhe pas hartimit të procesverbalit të datës 29.06.2020 si dhe pas analizës së mundësive financiare të drejtorisë, ju njoftojmë se në kuadër të projekteve infrastrukturore për ndërtimin e kanalizimeve në komunën e Rahovecit për 2020-2021 është planifikuar që të bëhet rregullimi i kanalizimit fekal në

lagjen tuaj, prandaj kjo drejtori ka vendosur si në dispozitiv. D.m.th. vendimi është marr, kurse rregullimi i këtij kanalizimi prej 60m nuk është kryer. Drejtor, a i din pasojat juridike të këtij vendimi?... (e di që nuk është i pranishëm, por besoj që do të marr përgjigje) dhe ku ka shkuar ky projekt, pse nuk ka përfunduar? Ky projekt është dashur të përfundoj 2020-2021.

Kryetari – Pasojat juridike i bartë drejtori dhe do të përgjigjet sigurisht penalisht për këtë temë (nuk po bëjë shaka). Ne kemi kontrata të cilat vazhdojnë së zbatuari që nuk janë zbatuar ende dhe nuk është e quditshme që një kërkesë aprovohet dhe llogaritet që ajo punë të kryhet, po nuk ka mund të kryhet, një kanalizim është kryer atje, i kemi shfrytëzuar disa mundësi në Brestoc bie fjala, e kësi vendime kemi shumë...

Vlora Vuqiterna – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Unë dua të lidhem pak tek raporti që na është sjellë nga drejtorja e shëndetësisë. Në fillim të këtij viti është vë në funksion mamografi- aparati për diagnostikimin e kancerit të gjirit, që për fat të keq prek shumicën e femrave. Padyshim që është për t'u përgëzuar drejtoresha e shëndetësisë për këtë hap të duhur, mirëpo sa janë të informuara gratë e komunës tonë që ky aparat është në funksion dhe që ato mund t'i kryejnë ekzaminimet e duhura sa jam në dijeni unë vetëm në fillim, kur është vërë në funksion ky aparat është bërë lajmi dhe përgjatë këtyre 3-4 muajve më nuk ka pasur ndonjë ri 'postim apo ri informim. Tjetër, komuna jonë duhet të ndërmerri iniciativa dhe organizime më të shpeshta rreth kësaj sëmundje, e jo të dalim vetëm simbolikisht një herë në vit gjatë muajit të ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit. Besoj shumë që iniciativat e tilla janë shumë të nevojshme për komunën tonë.

Sejfullah Sejfullahu – Përshëndetje për të gjithë, kryetar, nënkryetar, kryesues, drejtorja, kolegë asamblistë, t'a bëjë edhe unë një pyetje, po bëhem pak lokalist këndeje ka kultura, se ka Berati nuk ma don fort punën!...Kryetar, pak presion është mirë m'i bë operatorit për shtëpinë e kulturës, le ti jep zor pak, se tash i kemi edhe ushtrimet, që 2-3 herë po e ngrisë këtë çështje, bash me dashtë me marr betonin prej meje operatori, tash nuk e merr! Prej këtyre të urbanizmit se kush e ka bë projektin edhe pse privatisht të kisha pyetur kur të ishim takuar, projektin që janë duke e rregulluar në shesh, a ka mundësi një vend, po kanë qejf një shqiponjë një farë muri, ide shumë e mirë me pa në vizatim, për moment nuk e kam të gatshme, por kushdo që e ka bë projektin kam qejf me ja shtu edhe qatë se nuk bëhet kiameti!

Kryetari – Vlora ka të drejtë plotësisht, megjithëse ka plotë vizita që bëhen më në konfidencë dhe pajtohem plotësisht që duhet të ketë një fushatë informuese dhe sensibilizuese. Është një grup joformal i grave që duhet ndoshta edhe nga kuvendi me qenë më aktive dhe jam dakord në atë që the. Ne kemi nevojë ndoshta edhe të krijojmë edhe kushte më të mira, që ndoshta atë ta ndiejnë veten më të sigurt në përgjigjet ose shërbimet që i'u ofron mamografi. Po të bëjë thirrje, bashkë me grupin joformal të grave dhe filloni në këtë temë dhe mos t'a lëmë vetëm në tetor (muaji në ndërgjegjësimin e kancerit). Sëfajti e ka ngritë një çështje, ju e keni pa që këto kemi filluar mezi t'i bindim operatorët që duhet të punojnë sepse kanë telashe dhe ne jemi midis dy zjarreve që thotë populli, në njërin anë kemi të drejtë t'i ftojme operatorët për zbatim të kontratave sepse kemi marrëdhënie të firmosur dhe vulosur, duke e ditur që çmimet janë rritur shumë. Këto ditë kemi pas shumë sukses në rikthimin e operatorëve në punishte, "betejë" vazhdon...Por, ne nuk kemi arrit t'a bindim ende operatorin për ndërtimin të aneksit për nevojat e ansamblit "Bajram Curri" në Krushë të Madhe, i cili mund të korrigjohet jam shumë dakord. Ndërsa te sheshi, po sheshi tashmë është i hapur, janë ndërmarrë veprimet e nevojshme, janë zbatuar të gjitha procedurat ligjore dhe kemi arritur që pa i prish marrëdhëniet me askënd të zbatojmë ligjin dhe të krijojmë hapësira operatorit për t'a kryer punën e

vet. Në çoftëse ka kësi lloj kërkesash mund t'a akomodojmë ndonjë shqiponjë apo një simbol që jep një imazh për Krushe, jam dakord, mund të merremi vesh me operatorin, menaxher i asaj kontrate mesa e di unë është Albnor Mullabazi, mundemi t'a bëjmë një zgjidhje. Vonesat në zbatimin e kontratave vijnë si rrjedhojë e mungesës financave nga komuna, ndonjëherë edhe mungesa e seriozitetit të operatorit por kësaj radhe jemi ballafaquar me rritjen e çmimeve sepse ka pas një konsensus në pritje të një vendimi potencial të qeverisë për subvencionimin e humbjeve të supozuara në ato kontrata që janë lidhur para rritjes së çmimeve, operatorët po e shohim që nuk kemi ende vendim të qeverisë, nuk kemi qëndrim konkret se a do të ndodh ose jo, shtetet e rajonit ju kam treguar që e kanë bërë, por ne nuk kemi kohë të presim, aty ku kemi pak para e pak mundësi ne jemi duke iu bërë presion sistematik operatorëve të kthehen në punishte. Sivjet sfidë e kemi rrugën katër krosi, i kemi ndoshta 1.000.000eu dhe ende nuk ia kanë nisë të punojnë, arsyetimi është që asfalti (betoni) është shumë shtrenjtë. Mos t'i mbesë borxh Sinanit, e përmendi raportin e ZKA-së. Është e vërtetë që në opinion kanë ndikuar edhe subvencionimi i tri OJQ-ve përfituese që nuk kemi qenë në dijeni në atë kohë, vërtetimin e ATK-së e kanë dhënë të falsifikuar dhe janë OJQ që bukur kanë suksese, janë OJQ sportive. As komisioni nuk ka qenë në dijeni për këtë gjë, se ata kur nuk kishin marrë subvencione pa vërtetim valid. Në një pamundësi të komisionit për verifikim ka bërë që auditori të ketë këtë gjetje.

Merisa Sharku – Përsëritet për të gjithë, e përgëzoj kryetarin për gjetjen e burimit të ujit afër shtëpisë, në këtë rast desha të ndërlidhem me ankesën e banorëve të fshatit Senoc të cilët kanë problem me burime të ujit. Këtu e dimë që përgjegjësinë e ka Radoniqi, por desha të bëjë një kërkesë për kryetarin që të interesohet pak më shumë të bëjë tryzni ose bashkëpunim me Radoniqin që të vijë deri te një gjetje e një burimi të ujit edhe për këta banorë që të mos mbesin pa ujë sidomos këto muaj të verës që edhe kemi ardhje të mërgimtarëve. Te shtëpia e pleqve shpimi ka shkuar deri në 185m e për siguri më të madhe deri në 200m. Radoniqi në Senoc ka provuar deri në 130m. Kërkesa jonë është që kryetari ta rrisë bashkëpunimin me Radoniqin dhe të gjejë zgjidhje për banorët e fshatit Senoc.

Kryetari – Faleminderit Merisa, e keni ngritur një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme. Po, 130m dhe ndoshta pak më shumë kemi shkuar me shpim për kërkimin e gjetjes së burimit dhe nuk ka. Fatkeqësisht Senoci konsiderohet që ka varfëri në burime ujore. Është një projekt me Radoniqin që e ka bërë gati KRU Gjakova të cilit po i drejtohem nga kjo seancë në prani të mediave. Bashkëpunimin e kemi të mirë me KRU-në, ne paguajmë 49% në zbatimin e marrëveshjeve ata paguajnë 51%. Në momentin që fillon punën KRU ne jemi të gatshëm ti përgjigjemi, a do të filloj apo jo! Fondet KRU-Gjakova i merr nga ministria zhvillimit ekonomik, nëse ata i kanë të garantuara këto mjete, atëherë ne i japim garancinë për garantimin e mjeteve të cilat ne marrim pjesë. Shpresoj që ata do të bëhen gati, ne jemi gati.

Kryesuesi - Faleminderit kryetar, dikush tjetër ndonjë çështje?... Nëse jo atëherë po vazhdoj me pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00369-0 zonë kadastrale Mrasor;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, sipas ligjeve në fuqi para jush keni vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës 369-0 në zonën kadastrale në Mrasor. Pra, bëhet fjalë për 2 ari e 40m katror të mirët prej pjesës së përgjithshme të parcelës e cila është në të Sokol Rexhepi nga fshati Mrasor. Qëllimi i shpalljes i parcelës në interes publik është që të merremtojmë një shtab të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe pas kësaj do to

vazhdojmë me procedura tjera mbi faljen e kësaj pjese dhe t'a regjistrojmë në emër të pronës së komunës, ftoj anëtarët e kuvendit që të votojnë këtë vendim.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, dikush ndonjë gjë rreth kësaj pike?... Nëse jo atëherë po e vendosim në votim! Kush është për miratimin e kësaj pike?...Me shumicë unanime miratohet pika e tretë e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e katërt;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00759-0 në zonën kadastrale Retijë;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, sipas legjislacionit në fuqi para jush keni vendimin për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës 00759-0 në zonë kadastrale në Retijë, bëhet fjalë për parcelën që është në emër të Ilia Cvetka Nikolic me sipërfaqe 20 an e 58m katror, ne po e shpallim me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës prej 5 ari në këtë zonë. Atje pas luftës së fundit janë varrosur dëshmorë, martirë dhe civilë, ne e kemi meremetuar dhe jemi në proces të këmbimit ose shpronësimit në faza tjera të kësaj parcele pasi që fatkeqësisht na figuron në emër të një pronari privat, ftoj anëtarët që t'a votojnë vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, nëse ka dikush diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për miratim? ... Me shumicë unanime miratohet edhe pika e katërt e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e pestë;

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik – P- 01830-0, zona kadastrale Rahovec;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, media e ju të pranishëm. Para jush keni propozimin për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim për personat fizik dhe juridik si dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik. Prona e paluajtshme gjendet në zonën kadastrale në Rahovec, në vendin e quajtur “Ispod sëllo” konkretisht te parku “Toni dhe Mici” me nr. të pronësisë 01830-0 me sipërfaqe 5813m katror dhe se ne pretendojmë të japim në shfrytëzim vetëm një pjesë të saj me sipërfaqe prej 232m katror në periudhë afatshkurtër deri në 3 vite. Këto prona mund t'i shihni edhe në projektor, kjo pronë ka qenë e dhënë në shfrytëzim dhe i mbaron kontrata në gusht të këtij viti dhe se drejtorja për ekonomi zhvillim dhe turizëm planifikon t'a jap përmes ankandit publik. Ftoj anëtarët e kuvendit që të votojnë për këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi – Nëse dikush ka diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim pikën e pestë të rendit të ditës, kush është për miratim?...Me shumicë unanime miratohet edhe pika e pestë e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e gjashtë;

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P - 01830-0, zona kadastrale Rahovec;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, para jush keni propozimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite për prona të paluajtshme të komunës me nr. të pronësisë 01830-0. Ky komision përbëhet përbëhet prej 5 anëtarëve; 2 përfaqësues të kuvendit, 2 nga ekzekutivi dhe një nga sektori joqeveritarë, andaj ftoj anëtarët e kuvendit që t'a votojnë këtë pikë të rendit të ditës për formimin e komisionit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë siç e tha edhe drejtori, komisioni është i përbërë prej pesë anëtarëve, ku 4 prej anëtarëve janë nga kuvendi i komunës, ku çdo grup i asamblistëve mund të vendosë nga një anëtarë.

Erhan Morina – Kërkoj ndjesë, këtu zyra e kuvendit ka bërë një lëshim teknik sa i përket përpilimit të këtij vendimi, juve iu ka ardhur një vendim tjetër, nëse dëshiron edhe zyra ligjore mund t'a prezantoj se si duhet...

Kryesuesi – E ftoj zyrtarin ligjor për prezantim meqë është bërë ky lëshim nga sekretaria e kuvendit.

Mirsad Shala – Faleminderit kryesues, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, asamblistë. Zyra ligjore ka hartuar vendimin për formim të komisionit për zbatimin e procedurave për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Në pjesën hyrëse të këtij vendimi neni 17 i ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe paragrafi 1 dhe 2 i rregullores 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës ceket kështu; Neni 17 paragrafi 1 thotë; për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës formohet komisioni vlerësues në përbërje të 5 anëtarëve. Paragrafi 2 parasheh; kryetari i komunës propozon 2 anëtarë nga ekzekutivi, kuvendi i komunës propozon 2 anëtarë nga kuvendi i komunës dhe nga sektori joqeveritarë një anëtar, besoj që ka qenë një lëshim i sekretarisë së kuvendit që i ka cekur në bazë të partive politike gjë që nuk bënë kjo.

Kryesuesi – Faleminderit Mirsad, atëherë meqenëse prej anëtarëve të kuvendit vetëm 2 anëtarë e përbëjnë komisionin e 5 anëtarëve, po i kërkoj propozimet prej grupeve të asamblistëve, a i kemi më shumë se 2 propozime? Grupi i Aleancës? I Vetëvendosjes? I Lidhjes Demokratike? PDK?

Burim Krasniqi – Faleminderit shumë, meqenëse kemi të bëjmë me 3 komisione të partive të ndryshme e që janë të njëjtës natyrë, e njëjta përbërje, është mirë që këto komisione t'i bëjmë mbas pauzës duke gjetur një konsensus brenda grupit të asamblistëve komplet dhe të shkojmë tutje...

Kryesuesi – Meqë është edhe koha e pauzës, vazhdojmë me pauzë deri në ora 1, më pas vazhdojmë seancën...

Kryesuesi – I nderuar kryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, nënkryetar, drejtorë të drejtorive po e vazhdojmë pjesën e dytë të seancës pauzës kemi mbete te pika 6, formimi i komisionit për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, 2 anëtarë prej kuvendit komunal delegohen në këtë komision, i ftoj grupet e asamblistëve për propozime, Aleanca?

Besë Bytyqi - Faleminderit kryesues, për këtë komision, grupi i Aleancës propozon Feriz Thaqin.

Leonard Morina – Grupi i lëvizjes Vetëvendosje propozon Sinan Kryeziun.

Sejfullah Sejfullahu – PDK propozon, zonjën Melinda Iska- Oruqi.

Kryesuesi – Meqenëse i kemi 3 propozime, është i pashmangshëm votimi për secilin kandidatë, kisha propozuar që njëri prej grupeve të tërhiqet për këtë komision dhe t'ia bëjnë radhën për komisionin e radhës, nëse mundemi me arrite një koordinim të tillë!...Faleminderit për korrektësinë, atëherë 2 kandidatë janë Feriz Thaqi dhe Sinan Kryeziu si kandidatë që janë për t'u deleguar në komisionin për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Dy përfaqësues nga ekzekutivi edhe një prej sektorit joqeveritarë do të vendosen më pastaj. Kush është për formimin e këtij komisioni në këtë format?... Me shumicë votash aprovohet pika e gjashtë e rendit të ditës dhe themelohet komisioni në fjalë. Vazhdojmë me pikën shtatë;

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik – P- 01043-1, 01035-0, 01039-0 dhe 01036-2, zona kadastrale Xërxë;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit, media dhe ju të pranishëm. Para jush keni materialin për dhënien në shfrytëzim të një pjese të objektit i cili gjendet në depot e matrexit të fshatit Xërxë dhe sipas certifikatës së pronësisë këto parcela janë pronë e komunës dhe se komuna dëshiron t'i jap në shfrytëzim përmes ankandit publik në periudhë afatshkurtër deri në 15 vite, objekti është i destinuar për zhvillimin e aktiviteteve biznesore dhe sipërfaqja e përgjithshme e saj është 16.219m katror dhe në këtë vendim japim në shfrytëzim vetëm në pjesë të saj në sipërfaqe 1359m katror, poashtu në këtë vendim jepen në shfrytëzim përmes ankandit publik edhe këto parcela P- 01043-1 në vendin e quajtur "Skaja" kultur-kullosë të klasës së tretë me sipërfaqe 5016m katror. P-01035-0 në zonën kadastrale Xërxë në vendin "Skaja" kulturë-arë e klasit të tretë me sipërfaqe 2252m katror. P-01039-0 në zonën Xërxë, vendin e quajtur "Skaja" kulturë-kullosë e klasit të katërt me sipërfaqe 6506m katror. P-01036-2 në zonën kadastrale në Xërxë në vendin e quajtur "suga kot" kultur-arë e klasit e katërt me sipërfaqe 2445m katror. Të gjitha këto prona janë të komunës dhe se qëllimi i dhënies në shfrytëzim është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës komunale, pronat kanë qenë në shfrytëzim të cilave ju mbaron kontrata në gusht të këtij viti dhe drejtoria planifikon t'i jap prapë në shfrytëzim.

Kryesuesi - Faleminderit drejtor, nëse dikush ka diçka rrejt kësaj pike?.. Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për miratimin e pikës së 7 të rendit të ditës?... Me shumicë unanime miratohet edhe pika e 7 e rendit të ditës...Me propozim të kryetarit, me arsye që një agjendë të lëvizë tutje, propozoj që pika e 17 e rendit të ditës, raporti i punës së kryetarit nëse jeni të pajtimit që t'a vendosim si pikë të 8 të rendit të ditës!... e ftoj kryetarin që të raportoj për punën 6 mujore të ekzekutivit.

Kryetari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për anëtarët e kuvendit, nënkryetar, drejtorë, media, monitorues... Ne në muajin e 6 jemi të obliguar ligjërisht t'a paraqesim raportin mujor, kuptohet që raporti 6 mujor financiar nuk është pjesë e këtij raporti, i plotë duhet të bëhet në korrik. Këtu i keni prej një fjale hyrëse, janë zotimet, janë synimet, prioritetet, raportet e zyrave të kryetarit, zyrës ligjore, njësisë të auditimit të brendshëm, zyrës prokurimit, zyrës për barazi gjinore, zyrës për integritet europian. Pastaj janë raportet e secilës drejtori veç e veç, si dhe raporti i zyrës komunale për komunitete dhe kthim. Karakteristikë e këtij raporti është që ne i kemi paraqitur edhe angazhimet edhe aktivitetet, sfidat, arritjet po edhe ngecjet. E ndjej për obligim të ju drejtohem që ne kemi ngecje në investime publike, këto ditë ka disa lëvizje të mira, po është e vërtetë që kemi pas ngecje sepse rritja e çmimeve kanë ndikuar që një pjesë e operatorëve të mos përfshihen në zbatim të kontratave. Kjo karakteristikë nuk ka ndikuar që ne mos t'i kryejmë punët tjera të cilat i kemi. Gjatë kësaj periudhe kemi marr edhe vlerësime, në grantin e performancës jemi komuna e parë. Kemi fituar edhe grante nga ministritë e linjës sidomos nga MAPL dhe janë paraqitur aktivitete që e kanë prekur secilën drejtori të qeverisjes komunale të pasqyruara nga ana e zyrës së kryetarit të komunës. Ky raport është publik, është publikuar edhe në web-faqe që i bie të jetë subjekt diskutimi, unë mirë pres këshilla, propozimet, vlerësimet dhe kritikën të cilat ndikojnë që ne ta bëjmë punën sa më mirë në pajtim me ligjin dhe me obligimet që i kemi marr para qytetarëve. Në ora 2 do të jem në varrim, ka vdekë një nënë e dëshmorit, bashkëshortja e dëshmorit Xhemajl Gashi, do të shkoj aty se nuk bën pa qenë prezent, prandaj kërkoj falje që insistova ta marr fjalën sepse ndoshta kur të kthehem prej

varimit kryhet seanca. Raporti është në faqe zyrtare, faleminderit shumë me çrrastë i falënderoj drejtorët e drejtorive për punën sepse secila drejtori do të paraqes raportin e detajuar dhe do ta publikoj në linkun e drejtorive respektive. Ky është raporti i kryetarit dhe ekzekutivit, raporti i plotë. **Sejfullah Sejfullahu** – Përshëndetje, raporti ishte goxha voluminoz, vërejtjet, plotësimet ose diçka që na intereson mundemi t'i shtjellojmë në vazhdimësi edhe në seanca tjera nuk e besoj që është problem, mos të vonohemi...

Kryesuesi – Faleminderit Sejfullah, atëherë po e kalojmë këtë pikë të tetë të rendit të ditës, raportin gjashtë mujor të punës së kryetarit, kalojmë te pika e nëntë;

9.Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 01043-1, 01035-0, 01039-0 dhe 01036-2, zona kadastrale Xërxe;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë para jush keni propozimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite të pronave të paluajtshme të komunës, bazuar në vendimin paraprak të kuvendit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me nr. të pronësisë 01043-1 01035-0 01039 -0 dhe 01036-2, ky komision do të përbëhet prej 5 anëtarëve; 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 përfaqësues nga sektori joqeveritarë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, ashtu si komisioni i formuar paraprakisht edhe ky komision ka dy të deleguar prej kuvendit komunal, ju ftoj për mirëkuptim që grupet që kanë bërë propozime në komisionet paraprake që dy grupeve tjera t'i ofrohet propozimi; Grupi i LVV-së?

Merisa Sharku – Ne propozojmë Sinan Kryeziun në këtë komision, në komisione tjera lirojmë vend.

Kryesuesi – Faleminderit, grupi i LDK-së?

Lirigzon Kastrati - Përshëndetje, në emër të grupit të LDK-së, propozojmë z.Burim Krasniqin.

Kryesuesi – Atëherë meqenëse po pajtoheni me këtë përbërje të këtij komisioni, po e vendosim në votim formimin e këtij komisioni me këtë përbërje; Sinan Kryeziu dhe Burim Krasniqi si dy të deleguar prej kuvendit komunal, kush është për?...Me shumicë unanime formohet edhe komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, kështu po e përmbyllim pikën e nëntë të rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e dhjetë;

10.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025 dhe Qarkores Buxhetore 2023/1;

Afrim Limani – Faleminderit kryesues, përshëndetje për nënkryetarin, përshëndetje për asamblistët dhe të gjithë të pranishmit. Me datë 15 maj 2022 në adresë të komunës tonë ka ardhur qarkorja e parë buxhetore, në të cilën janë të përcaktuara limitet, tavanet për vitin 2023 si dhe projeksionet për vitin 2023-2025, ky buxhet sipas qarkores së parë buxhetore është prej 17.548.240 kjo rritje, ky total në kuadër të grantit të përgjithshëm të administratës është 7.605.075eu nëse bëjmë krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ndryshimi pozitiv është 1,844.000eu. Granti arsimit është 5.872.245, krahasimi me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka një zvogëlim prej 93.637eu. Granti i shëndetësisë është 2.638.000, krahasimi me vitin e kaluar është që kemi një rritje prej 648.990eu ndërsa të hyrat vetanake kanë një rritje prej 78.855 që aktualisht do të jenë 1.345.000eu. Në bazë të analizave dhe krahasimeve të viteve paraprake, ne si drejtori e financave shpërndarjen e buxhetit e kemi bërë në kategori ekonomike, jemi bazuar gjithmonë në raportet e zyrës kombëtare të auditorit pastaj edhe sugjerimet nga ministria e financave, duke e ditur që i kemi ikur keq klasifikimeve që deri

më tani janë krijuar, në zbatim të plotë të udhëzimit administrativ atëherë këtë buxhet në kategori ekonomike e kemi shpërndarë kështu;

Pozicioni i pagave 8.453.000 krahasimi me vitin e kaluar, ka rritje prej 580.244eu. Buxheti për mallra dhe shërbime do të jetë 2.203.829 një rritje prej 468.229 pra, kategorinë e mallrave dhe shërbimeve e kemi rritur për shkak të ikjes së keq klasifikimeve në bazë të një analize të bërë. Komunalit janë rritë prej 100.000eu me buxhet total 370.000. Subvencionet janë 820.000eu, krahasimi me vitin 2022 ka një rritje prej 460.000 edhe këtë kategori të shpenzimeve i kemi rritë duke i ikur keq klasifikimeve të cilat janë në kuadër të investimeve kapitale. Ndërsa investimet kapitale do të jenë 5.701.000, krahasimi me vitin 2022 kemi një rritje 885.507eu. KAB-in si dokument e kemi punuar shumë, jemi përgatitur shumë. Në kuadër janë të përcaktuar objektivat, strategjitë, prioritetet sipas sektorëve dhe sipas programit të kryetarit të cilën e ka paraparë në periudhën 3 vjeçare. Kemi bërë edhe shpërndarjen e të hyrave vetanake 2023-2025 projeksionet si dhe shpërndarjen e buxhetit, për fund një informatë; Te planifikimi i të hyrave për vitin 2023 te taksa për legalizimin e objekteve, një vendim sa kemi informata skadon në muajin shtator, ndërsa ne e kemi bërë planifikimin më shpresë që ky vendim prapë të afatizohet, sipas praktikave kështu ka ndodhur edhe më herët. Në dilemë jam por si planifikim ekziston, nëse ju keni ndonjë mendim mundeni të më ndihmoni në këtë pikë, në bazë të opinionit të juaj, d.m.th është fjala për taksën e legalizimit të objekteve. Për fund një lutje për votimin e kësaj qarkoreje buxhetore, sipas ligjit të buxhetit dhe në bazë të një formule që e ka caktuar "hisën" tonë në këtë buxhet.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, e kam përsëritur edhe më herët nëse gaboja ndonjëherë mos ma zini për të madhe sepse nuk jam ekonomist, jam inxhinier me profesion. KAB-in e kam lexuar me kujdes, ajo që më ka rënë në sy janë disa prej çështjeve. Te faqja 15-16 te planifikimi i të hyrave vetanake te rasti i inspektionit kemi një rritje të gjobave, faktikisht 2022 ka qenë 1000, 2023 është 5000, 2024 prapë 5000 ndërsa në 2025 është 10.000, kjo a nënkupton që do të rritet mos disiplina e bizneseve që duhet gjobitur apo ku është problemi?... Te shfrytëzimi i pronës publike, te shërbimet publike kemi rënie të të hyrave vetanake ndër vite, përderisa në vitin 2022 kanë qenë 4500, në 2023 është 3000, në 2024 – 2000eu, prapë në 2025 është 2500, është një far planifikimi joserioz i kësaj çështje, njësoj ndodh edhe çështja e qirasë së objekteve, sivjet e kemi 4700, bie në 3000 e tani shkon në 5000 këto kërcime në KPF kam thënë që janë pak të çuditshme ose është papërgjegjësi kur është bërë KAB-i ose mos aftësi, njëra prej dyjave del. Te bujqësia – zhvillimi rural, shfrytëzimin e pronës publike e kemi rregullisht në 2022 1000eu në 2024 1000 në 2025 1500eu pra d.m.th duhet të jetë së paku një rritje, e jo në mënyrë lineare. E njëjta gjë shkon edhe për taksat ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës, 2022-1000eu, 2023-1000, 2024-1000, 2025- 0euro... Te urbanizmi është pak më shumë e çuditshme te taksat komunale për leje ndërtimi janë disa shifra që nuk i kuptoj, ose vetëm i kanë qitë pa analizë, thotë; 2022 i ka 44.000, 2023 i ka 36.000eu, 2024 – 41.000eu dhe 2025 – 36.000eu janë disa kërcime të palogjikshme dhe nuk është diçka variabël, nuk është diçka që rrjedh, dhe te respektimi i planit urbanistik janë të hyrat vetanake ka 2000euro vazhdimisht përveç vitin e fundit që shkon me 2200eu. Te faqja 17 pika 3.2.1 donatorët e jashtëm ndërkombëtar, financimi nga donatorët e jashtëm gjatë vitit 2023-2025 presim që do të kemi donacione! A ka ndonjë projekt madhor, ndonjë projekt me perspektivë për të ardhmen, a ka ndonjë negociim deri tani, aplikacion? Sepse në çoftëse ka aplikacion për 2021-2021 nuk është projekt që zhvillohet për 6 muaj por shkon tutje, e shpreh gatishmërinë për punë, por nuk ka diçka që ndodh defakto. Drejtor, te pagat dhe mëditjet ka 13.6% rritje të shpenzimeve, duket pak si shumë po prapë është vlerësim i juaji.

Huamarrja e jashtme 000 komplet, ndoshta nuk ka ndonjë projekt që llogaritet, najë farë BERZH-i, ose dikush tjetër që komuna mund të merr kredi, duke pasur parasysh se minimumi që duhet të merret në konsideratë është kanalizimi i komunës që është copëza copëza dhe shfaq rrezik për shumë lokalitete. Te tabela e shpenzimeve faqe 21,22,23,24 tabelat 4,5,6,7 te çështja e pagave a hyjnë edhe mëditjet apo vetëm pagat, drejtor? (vetëm pagat). Zyra e kryetarit ka vazhdimisht rritje të pagave dhe për befasi është goxha afër komplet administratës, 2022 – 174.457euro i ka zyra e kryetarit, vetëm 216.182 i ka e gjithë administrata, 2023 – 178.520euro i ka zyra e kryetarit e 217.000 i ka komplet administrata. I njëjti trend vazhdon rritja edhe për 2024-2025, më duket që nuk është vetëm paga në pyetje, ndoshta i kanë pagat më të larta zyra e kryetarit me stafin e vet, por është e tepërt të jetë sa e gjithë administrata, së paku kështu mendoj unë edhe ndoshta janë punëtorët e punësuar dhe nuk mund t'i ikim kësaj. Te çështja e subvencioneve, zyra e kryetarit 2022 i ka 129.000euro këtë që e diskutuam paraprakisht e që nuk pajtohem, në 2023 subvencionet te zyra e kryetarit 160.000eu. Te kultura, rinia dhe sporti mbetet 100,000euro e njëjtë me vitin e kaluar, a nënkupton kjo që nuk do të përkrahet sporti 2023-2024-2025 sepse shkon 100.000 deri në 110.000 shkon njëjtë dhe nënkupton që rritje të aktiviteteve kulturore nuk do të ketë, te shtëpia e kulturës do t'a leni derën e mbyllur si e keni lënë deri tash. Konsideroj dhe propozoj që prej zyrës së kryetarit subvencionet të kthehen në 100.000eu dhe te kultura, rinia dhe sporti të kalojë në 160.000euro dhe të kemi në konsideratë sportin, kulturën dhe rininë, të njëjtën gjë propozoj të jetë edhe në 2024-2025 meqenëse është kornizë afatmesme buxhetore, sepse në këtë format që shihet nuk është serioziteti i mjaftueshëm në raport me sportin, rininë dhe kulturën. Te zhvillimi ekonomik është një subvencion prej 20.000euro ndër vite, një pyetje; çka subvencionon drejtorja e zhvillimit ekonomik? Cilat kategori?

Kryetar, te investimet kapitale, te arsimit fillor për 2023 janë vetëm 63.084euro, te arsimit i mesëm 30.200euro, te administrata e arsimit janë 159.395euro. Në 2024 arsimit fillor i ka 63.000euro në 2025 i ka 302.000, kur ti rumbullaksojmë të gjitha nuk bëhet 400.000euro. Po e marr një mesazh që këto shkolla; në Pastasel, në Xërxe, aneksi i shkollës në Ratkoc dhe nevojat tjera e këtu nuk është e planifikuar, konsideroj që duhet t'a kemi parasysh këtë çështje sepse kur të vijmë te buxheti të themi që nuk është planifikuar është e papranueshme. Propozoj që të rritet buxheti te investimet kapitale te arsimit fillor dhe i mesëm si projeksione buxhetore, pasi buxheti i detajizon dhe të rriten subvencionet në kulturë, rini sport, të reduktohen subvencionet te zyra e kryetarit. Te faqja 18, pika 3.1.2 e keni një gabim teknik të vogël thotë; viti 3 me siguri është 2023. Faleminderit shumë, respekt.

Afrim Limani - Burim, faleminderit për pyetjet dhe që i ngrite këto çështje, do të tentoj të përgjigjet me radhë; Te planifikimi i të hyrave, kemi diskutuar shumë edhe në mbledhjet e tjerat, kur kemi diskutuar për raportet periodike financiare ne e kemi një limit prej 1.445.000euro, në faqen nr.15 tatimi në pronë është 423.000, tatimi në tokë është 367.000.. këto lloj të tatimeve përbëjnë këtë shumë 880.000 dhe janë të përcaktuara me ligj limitet dhe tavanet në kuadër të departamentit të buxhetit të ministrisë së financave, brenda kësaj vlere ne duhet t'a bëjmë planifikimin e të të hyrave, e kështu po dalim jashtë planifikimit real sepse detyrimisht duhet t'i zvogëlojmë disa lloj të të hyrave në mënyrë që të arrijmë këtë limit që e kemi, e pranoj që nuk është një planifikim real por duhet patjetër të përshtatet tavanin që e kemi prej 1.445.000 nuk guxojmë t'i ikim. Te projeksionet, të them të drejtën nuk iu kam dhënë rëndësi të madhe sepse për çdo vit ndryshojnë dhe nuk mbesin të njëjta, por është një formalitet që duhet të plotësohet. Te donacionet, komuna e Rahovecit vazhdimisht ka pas dhe do të ketë, por ne në qarkore i kemi përfshirë vetëm ato që janë të regjistruara në sistem, në këtë kornizë të buxhetit çdo gjë është e përcaktuar me ligj dhe për këtë arsye duhet t'i përfshijmë vetëm në kuadër

të sistemit. Te shpërndarja e buxhetit, te planifikimi i buxhetit në kategori; te paga dhe mëditjet; këto janë të njëjta, nuk ndryshojnë, kjo rritje është si rezultat i përvojës së punës me 0.5%, pagat mbesin të njëjta, kategoritë tjera ne i kemi rritur për arsye të ikjes së keq klasifikimeve, e në anën tjetër kemi rritje të buxhetit prej 2.448.000euro. Subvencionet në kulturë d.m.th janë të vogla në krahasim me zyrën e kryetarit, të them të drejtën këtu i kemi dhënë prioritet të madh planifikimit të shpenzimeve, gjithmonë duke shikuar mostrat e kaluara dhe karshi nevojave dhe kërkesave që do të vijnë në të ardhmen. Konsideroj që 100.000euro subvencioneve në kulturë karshi kërkesave janë të mjaftueshme e në anën tjetër zyra e kryetarit i ka goxha disa kërkesa dhe shpenzime që mund t'i shihni edhe në raporte periodike financiare, ta dimë që në kuadër të zyrës së kryetarit janë edhe bursat për student që janë përafërsisht 80.000euro, pastaj zyra e kryetarit lëshon vendime të ndryshme, për persona me nevoja të veçanta, për shëndetësi et... dhe konsideroj që shuma prej 160.000 euro është e mjaftueshme këtu dhe 100.000 janë të mjaftueshme në kulturë. Investimet kapitale; unë thash në fillim që pjesën e investimeve kapitale do t'a votojmë dhe to ta diskutojmë në shtator, këto janë vetë projeksione dhe sipas ligjit drejtorive respektive i takojnë po aq para dhe nuk guxojmë të dalim jashtë kësaj qarkore, po ne gjithsesi viteve të kaluara dhe deri më tash janë rritur si drejtorja e arsimit tani i ka rreth 600.000euro investime kapitale, sepse kodi i administratës së përgjithshme ka të drejtë të financoj grantin specifik të arsimit dhe shëndetësisë e ndërsa ata nuk kanë të drejtë me neve. Këto janë Burim, faleminderit shumë.

Nora Boshnjaku – Burim, një pyetje e bëre për planifikimin e gjobave në inspektoriat, jo ne nuk kemi ardhur t'i gjobisim bizneset, të dëgjova me vëmendje. Një gjë interesante që për dallim prej viteve tjera, ne e kemi pasur një realizim pak më ndryshëm që i bie kemi gjeneruar më shumë se sa duhet. Shembull; deri tani kemi pasur 6000euro të hyra dhe nëse planifikohet për vitin tjetër më pak se që realizohet, atëherë veç që ia lehtësojmë punën vetvetes, në këtë rast kishim pas dëshirë që mos të shqiptojmë gjoba hiç, por janë disa procedura që ti i njeh më mirë. Ne nuk kemi ardhur të planifikojmë sepse nuk mund t'i dimë sa keqbërës janë, sepse ne nuk i gjobisim vetëm bizneset, ne kemi sektor të mjedisit, ndërtimtarinë, ka ardhur edhe ligji mbi inspektimet, jemi të detyruar të planifikojmë e “ishalla nuk i realizojmë” sepse nuk kemi ardhur t'i gjobisim qytetarët por nëse kemi situata që shfaqen në ndërtim, në mjedis, në inspektoratin sanitarë që tani ka kaluar në kuadër të AVUK-ut atëherë duhet t'i shfrytëzojmë të gjitha këto mjete, përndryshe ne gjenerojmë edhe të hyra prej kërkesave të qytetarëve që na bëhen për inspektime, prej pëlqimeve të punës etj.. kështu që është mirë të na kontaktoni, bisedojmë edhe ju shpjegojmë, nuk është që kemi rritur planifikim që ti gjobisim qytetarët, mirëpo realizimi është tjetër dhe dalim më mirë nëse planifikojmë të hyra të tjera.

Burim Krasniqi – Drejtor i financave fillimisht, te çështja e subvencioneve te kulturë, rini dhe sport, besoj që drejtori nuk do t'a lejoj që kështu të vazhdohet kultura e rinia, pa sportin që po e tërheqim sportin, planifikimi buxhetor shkon 2024-2025 100.000-110.000 e tani në 2023 është 100.000 i njëjtë me vitin 2022, kjo nënkupton që nuk do të ketë teatër amatorë, nuk do të ketë teatër për fëmijë, nuk do t'i hapet dera këtyre shtëpive të kulturës në Krushe, Ratkoc, Xërxe, Drenoc përpos kur mbajmë aktivitete politike ose dëgjime publike tjetër gjë nuk ka në të. Konsideroj që kjo e kufizon mundësinë që drejtorja kulturë, rini dhe sport t'i qaset më mirë financiarisht punës. Unë e kuptoj dhe besoj se te çështja e sportit ndoshta edhe keni të drejtë, që me kalimin e kohës bashkëpunohet në mes bizneseve edhe sporteve që të kalohet prej subvencioneve në donacione meqenëse e lejon ligji për financimin e OJQ-ve dhe klubeve sportive. Drejtoresh, çështja e gjobave është decedive, inspekcioni thotë; gjoba nga inspektorati 2022-1000, në 2023-5000euro, 2024-5000, në 2025-10.000eu. Besoj që kur t'i

dënimi 200-300 në 2023 e 200-300 në 2024 do të bie numri sepse do të vetëdijesohet, e jo në këtë rast të rritet numri i atyre që duhet të dënohen. Drejtor, te investimet kapitale meqenëse na dhe një aryetim; a nënkupton që nuk e bllokun mundësinë e financimit në arsimin fillor dhe të mesmen në të ardhmen me këtë kornizë buxhetore?...

Afrim Limani – Burim, po e përsëris edhe një herë, buxhetin e kemi votuar në shtator, kemi parë që pjesa e investimeve kapitale për drejtorinë e arsimit do të ketë rritje, 500.000 po, por edhe më tepër që kaq. Granti i përgjithshëm i administratës, në këtë rast që jemi në drejtorinë ka të drejtë të financojmë grantin specifik për arsim dhe shëndetësi kjo është e rregulluar me ligj, kështu që në mundemi t'i furnizojmë ata, e ata neve kështu që të garantoj që buxheti për investime kapitale për arsim do të jetë mbi 500.000euro.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, nëse nuk ka dikush ndonjë gjë lidhur me këtë temë, atëherë po e vendosim në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës, kush është për?...kundër?...abstenim?...Me 16 vota për, dhe 2 abstenime miratohet edhe vendimi për kornizën afatmesme buxhetore dhe qarkoren buxhetore, kalojmë te pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës;

11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës personave fizik dhe juridik – P-01038-2, 01055-2, 01034-0, 01045-0, 01033-2, 01044-0, 01040-0, 01036-2, zona kadastrale Xërxë;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush keni materialin për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të cilat gjenden te depot e Matreksit në Xërxë, sipas certifikatës së pronësisë janë prona të komunës dhe se komuna dëshirën t'i jap në shfrytëzim përmes ankandit publik në periudhë afatshkurtër deri në 15 vite, bëhet fjalë për parcelat; 01038-2 në zonën kadastrale Xërxë, vendi Skaja, zonë e klasit të 4 me sipërfaqe 1231 m katror, P-01055-2 në zonën kadastrale Xërxë, vendi Skaja, me kulturë kullosë e klasit të dytë me sipërfaqe 362m katror, parcela me nr. të certifikatës së pronësisë 01034-0 në Xërxë, vendi Skaja, me kulturë arë e klasit të tretë me sipërfaqe 549m katror, P-01045-0 në zonën kadastrale në Xërxë në vendin e quajtur Suga kot, me kulturë e klasit të tretë me sipërfaqe 4138m katror, P-01033-2 në zonën kadastrale në Xërxë në vendin e quajtur Skaja me kulturë arë e klasit të tretë me sipërfaqe 2162m katror, P-01044-0 në zonën kadastrale Xërxë, vendi Skaja, me kulturë të klasit të tretë me sipërfaqe 2142m katror, P-01040-0 në zonën kadastrale në Xërxë me sipërfaqe 1491m katror dhe se për shfrytëzim jepet vetëm një pjesë e kësaj sipërfaqe 400m katror, P-01036-2 në zonën kadastrale në Xërxë, vendi Suga kot me kulturë arë e klasit të katërt me sipërfaqe 2445m katror dhe se në shfrytëzim jepet vetëm një pjesë e saj me sipërfaqe 1700m katror, qëllimi i dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës komunale, ftoj anëtarët e kuvendit për votim në këtë pikë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, a ka dikush të shtoj diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo, atëherë po e vendosim në votim pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës; kush është për?...me shumicë unanime aprovet kjo pikë, vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës;

12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-01038-2, 01055-2, 01034-0, 01045-0, 01033-2, 01044-0, 01040-0, 01036-2, zona kadastrale Xërxë;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë, para jush keni propozimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 viteve të pronave të paluajtshme të komunës. Bazuar në vendimin paraprak të kuvendit për

dhënien në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të komunës me nr. 01043, 01035-0, 01039-0 dhe 01036-2 ky komision përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 nga kuvendi komunal, 2 përfaqësues nga ekzekutivi dhe një përfaqësues nga sektori joqeveritar.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë njëjtë sikur në dy komisionet e formuara të mëhershme edhe në këtë komision 2 anëtarë delegohen prej kuvendit komunal, ju ftoj për propozime;

Besmire Bytyqi (AAK) – Ne propozojmë kolegun tonë këshilltar, Feriz Thaqin edhe për këtë komision!

Merisa Sharku (LVV) – Nuk kemi propozim!

Edona Kryeziu (LDK) – LDK-ja nuk ka propozim!

Sejfullah Sejfullahu (PDK) – Melinda Oruqin!

Kryesuesi – Faleminderit për mirëkuptimin për të gjithë grupet e asamblistëve, atëherë dy anëtarë të deleguar nga kuvendi komunal, janë Feriz Thaqi dhe Melinda Oruqi, me këtë përbërje po e vendosim në votim pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës, kush është për?... Me shumicë unanime miratohet kjo pikë e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë, por së pari 5 minuta pauzë më pas rikthehem ...

Kryesuesi – Përshëndetje edhe një herë, po e vazhdojmë seancën, kemi mbete te pika e 13-të;

13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publike;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush sipas ligjeve në fuqi, keni vendimin për këmbimin e pronës komunale me pronë të institucionit qendror, bëhet fjalë për zonë kadastrale në pastasel, pra po kërkohet të jepet pëlqimi për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik që gjendet në vendin e quajtur Rezinë, zonë kadastrale Pastasel me nr. 944-0, sipas certifikatës së pronësisë është e komunës së Rahovecit me sipërfaqe prej 10 ari nga pjesa e përgjithshme prej 33ari e 21m katror i jepet ekonomisë së pyjeve me nr. të pronësisë 386-1 e cila është në emër të pasurisë shtetërore të Kosovës KK Rahovec, shfrytëzues; ekonomia e pyjeve Rahovec me sipërfaqe prej 2 hektar 20 ari e 5m katror, i merret pronës komunale sipas nr. të cekur më lartë dhe i jepet agjencionit pyjor në shfrytëzim prej 10 ari, po kërkojmë pëlqim prej juve që të këmbejmë pronën komunale me pronë e cila është nën menaxhimin e agjencionit pyjor në sipërfaqe të njëjtë prej 10 ari. Ftoj anëtarët e kuvendit që t'a votojnë këtë pëlqim.

Sejfullah Sejfullahu – Dëshiroja të dija që a ka edhe pronë tjetër aty, apo vetëm kjo që foli drejtori, më fal drejtor por e kam nga kureshtja, e jo me prishë punë.

Afrim Oruqi - Për shkak të ekonomizimit të kohës, nuk e përmenda që në landë e një raport të komisionit të cilin e formon kryetari i komunës i cili është në përbërje prej gjeodetëve, juristëve dhe zyrtarëve tjerë, këta e kanë për obligim daljen në terren dhe të përpilojnë një raport ku vlerësojnë llojin e pronës, shfrytëzimin aktual etj.. Uroj që mos të na kthehet, sepse ne po ia marrim agjencionit pyjor të Kosovës brenda fshatit Pastasel, është zonë ndërtimore. Është në interesin tonë sepse vlera është shumë më e mirë ku po marrim, se sa ku po e japim. Ka një raport të anëtarëve që e keni me shkrim, ku është vlerësuar që është përafërsisht e përafërt me llojin e pronës që këmbehet.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës, kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet edhe pika e 13-të e rendit të ditës, kalojmë te pika e katërbëdhjetë;

14. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr. 306/22 i datës 29.04.2022 për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve në komunën e Rahovecit i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin 01-Nr. 334/22 të datës 31.05.2022;

Mirsad Shala – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, asamblistë... Komuna e Rahovecit ka marr vendim me nr.306/22 për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve në komunën e Rahovecit. Pas konfirmimit të MAPL-së dhe ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor ne në seancën e mbajtur më 31 maj e kemi plotësuar dhe ndryshuar konform shkresave të ministrive të lartcekura. Mirëpo prapë para disa dite ka ardhur konfirmimi që prapë duhet të hyn në konfirmim të ligjshmërisë, brenda afateve ne jemi të obliguar që t'a shfuqizojmë dhe në seanca tjera, të shohim se ku qëndron problemi edhe pse viteve të kaluar ka qenë komisioni i njëjtë. Duhet shfuqizuar për shkak afateve kohore.

Burim Krasniqi – Në fillim të seancës thash që vendimet që duhet të shfuqizohen duhet të vijnë me material shoqërues, është e jo mjaftueshëm bindëse të themi; marrim një vendim për të plotësuar një tjetër, tani duhet të marrim një vendim që t'i shfuqizojmë dy vendime. Pse ka ardhur një shkresë me arsyetime të paarsyeshme, nuk po e kontestoj që kërkesa për shfuqizim të vendimit është në rregull, e as nuk po them që zyrtari ligjor na thotë atë që nuk qëndron, por secili asamblistë duhet të jetë i informuar se çka po votojmë, me këtë format është shumë hipotetike, votojmë të shfuqizojmë diçka që e kemi votuar dje, e kemi plotësuar prapë dhe në fund po e shfuqizojmë pa e pasur materialin edhe pse kur ka ardhur për plotësim ndryshim prapë nuk ka pasur material shoqërues, e dyta herë përsëritet i njëjti send.

Kryesuesi – Faleminderit Burim për këtë kritik me vend edhe unë jam për njoftimin e anëtarëve të kuvendit në atë moment kur prej autoritetit mbikëqyrës kërkohet që të rishikohet vendimi i marr në seancat e rregullta të kuvendit, besoj që zyra ligjore ose zyra e kuvendit në momentin kur e pranojnë vendimin prej MAPL-së atëherë të iu dërgohet anëtarëve të kuvendit për njoftim paraprak... Atëherë po e vendosim në votim shfuqizimin e këtij vendimi, d.m.th pikën e 14 të rendit të ditës, kush është për?... Me shumicë unanime shfuqizohet vendimi nr.306/22... vazhdojmë me pikën e pesëmbëdhjetë;

15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 333/22 i datës 31.05.2022 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71513005-02756-0 në Zonën kadastrale Krushë e Madhe;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit para jush keni materialin për shfuqizimin e vendimit të datës 31.05.2022 për shpalljen në interes të përgjithshëm për parcelën nr. të certifikatës së pronësisë 02756-0 në zonën kadastrale Krushë e Madhe, kjo pikë realisht është kthyer nga MAPL-ja për faktin që në këtë zonë sipas PZHK-së së vjetër nuk është paraparë ndërtimi i objekteve, ndërsa kërkesa jonë ka qenë për shpallje në interes të përgjithshëm e që më vonë ta shpallim si hapësirë për biznese dhe kjo ka qenë arsyeja se MAPL-ja e ka kthyer këtë pikë të rendit të ditës dhe ne me miratimin e PZHK-së së re, planifikojmë që në këto zona të lejohet ndërtimi e më pas do t'a vendosim prapë në kuvend.

Sefjullah Sejfullahu – Drejtor, unë edhe paraprakisht u konsultova me juve dhe desha të them që zyra ligjore duhet të shqetësohet për këto gjëra, ta dinë çka të votojmë në kuvend e çka mos të votojmë sepse është bërë një far “lufte” i gjithë ai hidhërim me njerëz të zonës atje, e tash të anulohet, shumë absurde kjo formë, e pafalshme kjo dhe sinqerisht po më vije inat.

Burim Krasniqi – Për sa po arrij të kuptoj, më duket që është rasti që kemi diskutuar rreth 3 orë që t'a vendosim në rend dite, me arsyetimin që po nuk hyri në rend të ditës aty bëhet "kërrsh" me uzurpime dhe nuk bënë të shtyhet për seancën e rregullt, duhet patjetër të vendosim. Çka ndodh tani kur të kalon PZHK-ja, a bëhet skandali që është prezantuar këtu, a e marrim këtë parcelë apo çka bëhet? Në çoftëse atëherë nuk ka mund të shtyhet për një seancë tjetër (një muaj) tash duhet të shtyhet për 5-6 muaj, çka ndodh tani?.. Kjo nënkupton që atëherë nuk ka qenë rreziku i prezantuar ose tash duhet t'a gëlltisim rrezikun dhe të lejojmë të bëjnë çfarë të dëshirojnë aty pari. Të jemi pak më serioz, po flas për ekzekutivin, kur të insistojmë diçka me hy në rend të ditës me një arsyetim shumë të fuqishëm, të jemi pak më solid në arsye. Për mua është obligim shfuqizimi për shkak të obligimeve ligjore që dalin, kështu që mos të vijmë në situata që për diçka insistohet e defakto nuk ekziston. Në fillim më kanë këqyr pak çuditshëm kur kam thënë që mos të marrim vendime që e vendosin kuvendin në lajthitje, kjo është lajthitje e kuvendit siç kanë qenë poashtu edhe dy vendimet më herët.

Ilir Pallqa - Faleminderit kryesues, nëse ka mundësi tjetër herë t'a bashkëngjitni vendimin e MAPL-së që ne ta kemi situatën më të qartë dhe po i bashkëngjitëm hallit të kolegëve, Sejfullahut sidomos. Kryetari jepke goxha "zor" për përfundimin e kësaj pune dhe vazhdimisht u mbështeste në përvojën e tij "500 vjeçare" si ekzekutiv, tani ose nuk din ose po manipulon, sepse vazhdimisht të gjitha vendimet po kthehen, a punon dikush këtu, a jo? Zyra ligjore? e krejt?...

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues, në lidhje për këtë çështje është një shprehje e mirë "tuj pa tuj bo" kështu që ndërkohë mund të ia marrin dorën.

Afrim Oruqi – Pyetja e kuvendarit Sejfullah Sejfullahu në lidhje me vendimin e MAPL-së për kundërligjshmërinë e vendimit për interes të përgjithshëm, parcela në fjalë është pronë shtetërore e Kosovës KK Rahovec – Ujërat, këto parcela që shkruan "Ujërat" nuk menaxhohen prej kuvendit komunal të Rahovecit. Në ministrinë përkatëse që i vlerëson ligjshmëritë e këtyre vendimeve, ka dy muaj na kthehen vendime që ne nuk i kemi në menaxhim, ndoshta kanë pranuar zyrtarë të ri... Në vendim të kundërligjshmërisë thotë; Arsyeja që ky vendim është kthyer mbrapa si i kundërligjshëm është që pronat që janë komunës nuk keni nevojë t'i shpallni në interes të përgjithshëm, vazhdoni caktoni hapësirë për lokacione, nëse shkruan në certifikatë PZHK – Ujërat, menaxhohet prej agjencionit i cili është në kuadër të ministrisë së mjedisit, nuk e ka lexuar asnjëri nga ju! Ne kemi dashtë që atë parcelë që është e agjencionit të ujërave t'a shpallim interes të përgjithshëm dhe pastaj ta kthejmë këtu në kuvend dhe ta caktojmë si hapësirë për biznese, në vendimin e kaluar që e kanë shpallur të kundërligjshëm, te qëllimi; kemi shkruar që qëllimi ynë është t'a bëjmë hapësirë për biznese. Ky kuvend në mandatin e kaluar ka shpallë në interes të përgjithshëm parcela që janë në menaxhim të ujërave e që janë kthyer të ligjshme prej këtij sektori, prej MAPL-së e prej këtyre zyrtarëve. Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi dhe kuvendarit Ilir dhe të Sinanit në lidhje me këto që a ka mundësi këto gjëra të shikohen më mirë. Brenda kohës sa keni qenë duke ndenjur në pauzë, neve na ka ardhur një vendim në një zarf tjetër për ligjshmërinë e një akti, tash dua ta citoj se si ia japin miratimin një vendim të një kuvendi këta zyrtarë. Ju në mbledhjen e kaluar keni formuar një kryesi për këshillin e fshtatit Hoçë e Madhe, pra d.m.th. komision obligativ, e ata thonë kështu; Për kryetarin e komunës dhe kryesuesin e kuvendit; Konfirmohet ligjshmëria e aktit, (e nënshkruar prej ministrit të MMPH z.Liburn Aliu) Vendimi nr.328-22 për miratimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të këshillit të fshtatit Hoçë e Madhe miratuar nga KKK (Komision i kuvendit komunal), thotë është i ligjshëm dhe në arsyetim thotë; Kuvendi komunal me rastin e nxjerrjes së vendimit është bazuar në dispozitat ligjore për fshatin Hoçë e Madhe dhe në udhëzim administrativ për themelimin

zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e këshillit të fshatit andaj si i tillë vendimi prodhon efekte juridike meqenëse lokacioni për ndërtimin e objektit, (po çfarë objekti në Hoçë të Madhe, këshill kemi formuar në kuvend) – Skandal, ja me kënd punojmë ne, brenda dy muajve na kthejnë vendimet, tash ju printoj edhe ju jap të gjithëve, deri sa këta zyrtarë atje ia marrin dorën punës, uroj të ia marrin shpejt, ne obligohemi brenda 30 ditëve t'i shqyrtojmë, plotësojmë ...

Kryesuesi – Besoj që është gabim teknik i atyre zyrtarëve në MAPL, përndryshe gabimet teknike falen besoj, por vërejtjen e kuvendarëve Ilir Pallqa dhe Sinan Kryeziu ishin me të drejtë.

Sejfullah Sejfullahu – Drejtor, faleminderit për sqarimin të cilit e thatë pak me cinizëm ishte, por të faleminderit shumë, e kuptoj që neve MAPL na ka bërë me hile, atëherë unë po insistoja që ne t'i padisim dhe mos ta shfuqizojmë hiç vendimin tonë.

Ilir Pallqa – Po të kishte qenë në rregull e gjitha, këta e kishin bashkangjitur vendimin e MAPL-së, unë dyshoj në manipulime.

Besë Bytyqi – E falënderoj drejtorin Afrim që na tregoj se çfarë qeverisje amatore e kemi në Prishtinë, po ndoshta ndonjë dajë i nipit të Liburn Aliut ndoshta e ka shkruar, e ata nuk dinë. Drejtor, ndoshta ia marrin dorën.

Kryesuesi – Faleminderit shumë, politikat nacionale janë goxha të rënda, atëherë jemi te pika e 15-të e rendit të ditës, te shfuqizimi i vendimit 01 nr. 333-22 i datës 31.05.2022, kush është për?...Me shumicë unanime shfuqizohet ky vendim, jemi te pika e 16-të e rendit të ditës;

16. Informatë nga drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;

Berat Duraku – Faleminderit kryesues, të drejtuar drejtorë, anëtarë, para jush keni dokumentin që paraqet informatën për periudhën gjashtë mujore të drejtorisë së bujqësisë. Ky raport është i shpërndarë në dy periudha, pjesa e parë ka të bëjë me aktivitetet të cilat janë zhvilluar me takime të ndryshme, ndërsa pjesa e dytë me pjesë e investimit kapital që investohet në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Përpara e keni materialin, besoj që e keni lexuar, unë desha të ndalem vetëm te fermerët të cilët kanë aplikuar për fazën e pagesave direkte për vitin 2022. Siç e shihni para jush e keni një tabelë, gjithashtu është edhe në materialin e juaj, ku janë të grumbulluar të dhënat e fermerëve të cilët kanë aplikuar për fazën e pagesave direkte të cilat janë të rregulluara sipas sektorëve, kemi edhe krahasimin 2020-2021 dhe 2022. Në fund e keni diferencën e vitit 2022 në raport me vitin 2021, këtu shihet rritja ose zvogëlimi i fermerëve që kanë aplikuar. Në sllajdin tjetër mund të vëreni që sektori i drithërave ka pas një rritje shumë të madhe në këtë pjesë të aplikimi i fermerëve duke e krahasuar me hektar vitin 2021 ishin 2019ha në këtë vit i kemi 3711ha, kjo nuk do të thotë që vitin e kaluar nuk kemi mbjellë drithëra, por për shkak të disa problemeve të shfaqura gjatë aplikimit të cilin ne e kemi kundërshtuar ashpër, fermerët nuk kanë mundur të aplikojnë. Si rezultat i kësaj këtë vit kemi rritje të sipërfaqeve për 92.6%. Sektori i vreshtarisë nuk ka pas dallime të mëdha për këto vite, krahasuar me sektorin e verëtarisë, ku këtë vit si rezultat i mungesës së tregut të prodhuesve të verës, sigurisht ka ndikuar edhe pandemia, i kemi rreth 1.414.000L më pak prodhim të verës për vitin 2022 të deklaruar për ministrinë e bujqësisë. Në sektorin e perime-kulturës, edhe këtu nuk ka patur shumë dallim, dihet që perimekultura dominohet prej 4 kulturave; specit, patates, lakrës edhe qepës, rreth 150 ha dominohet prej kungullit, shalqinit edhe pjeprit, këtu kemi rritje. Këtu ka qenë një gabim teknik i ministrisë që i ka stimuluar bujqit e Rahovecit për mbjellje të kungullit e që në fillim është thënë që do të paguhen njëjtë sikurse perimet e tjera, por më vonë kanë dalur e kanë korrigjuar gabimin e tyre. Pemëtaria dhe perimet në serra është një sektor jo shumë i zhvilluar, por trendi i këtyre është në rritje sikurse te pemëtaria në vitin 2020 janë 94 ha, në 2021 janë 131 ha, në 2022 janë 165 ha këtu

dominimi kryesor është kumbullës, arrës dhe një pjesë më e vogël e lajthisë. Perimet në serra nuk i kemi të specifikuar edhe ky trend është në rritje për shkak të mbështetjes që është nga ministria dhe komuna, kriter i ministrisë për subvencione ka qenë që serrat mos të jenë më të vogla se 5 ari.

Spektori i blegtorisë, shpezatarisë dhe i bletarisë fatkeqësisht është spektori i fokusuar në rënje krahasuar 2020, 2021, 2022 e vëreni diferencën në krahun e djathtë të sllajdit , kjo është një shqetësim për neve, për anëtarët e kuvendit dhe për të gjithë qytetarët e Rahovecit. Te spektori i shpezatarisë – pulave kemi një rritje prej 15,740 në bazë të deklarimeve që i kanë bërë fermerët. Tash e kemi pjesën e mjeteve monetare që komuna e Rahovecit do t'i realizoj për vitin 2022 në bazë të pranimi të fermerëve për subvencione. Lajm i mirë që për këtë vit ne i kemi diku 5.5 milion euro që fermerët do t'i marrin në kuadër të programit që ka qenë 25 milion, ne si Rahovec i marrim 5.5 prej tyre në këtë fazë. Krahasuar me vitin e kaluar diku 1.7 milion janë më shumë, këtu ka qenë fokusi spektori i drithërave që është rritë sipërfaqja por edhe përkrahja kryesisht për spektorin e grurit. Në vitin e kaluar kemi arritur të fitojmë 146.000eu, në këtë vit kjo përkrahje ka tejkaluar shumën prej 710.000eu, që i bie 385% më shumë. Spektori i rrushit poashtu ka rritje në vlerë monetare, në këtë vit është njëjtë për secilën parcelë që i bie 1000euro për hektar duhet përfshirë edhe derivatin 54euro për ha. Në fund e kemi një sllajd i paraqitur grafikisht të gjitha spektorët në vlera dhe në përqindje që janë për këtë vit. Këtu i kemi tri kolona me ngjyrë të gjelbër; subvencionimi bazë, subvencionimi për derivate, subvencionimi për pleh. Në pjesën e parë subvencionimi bazë dallon për secilën kulturë specifike, në pjesën e dytë është pjesa e derivateve ku është unike për të gjitha kulturat, pjesa e tretë plehërimi dallon nëpër kultura, që për këtë vit me pleh artificial janë të subvencionuara vetëm katër kultura; gruri, misri, fasulja, patatja...Kaq pata, pres sugjerime, kritika dhe lëvdata...

Sejfullah Sejfullahu – Dëgjova që the subvencionimi prej ministrisë së bujqësisë, që nuk i ka subvencionuar serrat nën 5 ari, apo jo? A i kemi bërë ndonjë vërejtje ministrisë së bujqësisë, ndonjë kërkesë? Po flasë si Krushian, na shumicën e serrave i kemi nën 5 ari, mendoj që duhet të rregullohet edhe në të ardhmen të subvencionohen, sepse ai që i ka 2 ari duhet t'i ndihmojmë që ta rrisë serrën dhe ta bëjë më të madhe se 5 ari.

13480	Shpenzimet për Antaresim 21	0.00	5,000.00	5,000.00	#DIV/0!

13490	Sherbimet e Varrimit	60,800.00	31,800.00	-29,000.00	-47.70
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	0.00	13,321.00	13,321.00	#DIV/0!
13503	Komputerë (me pak se 1000 euro)	5,119.00	2,290.78	-2,828.22	55.25
13506	Pajisje speciale mjeksore (me pak se 1000 euro)	0.00	30,000.00	30,000.00	#DIV/0!
13508	Pajisje trafiku (me pak se 1000 euro)	0.00	289.00	289.00	#DIV/0!
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	16,031.00	15,259.59	-771.41	-4.81
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)-21	0.00	10,491.00	10,491.00	#DIV/0!
13510	Blerja e Librave dhe veprave Artistike	5,477.09	99.00	-5,378.09	-98.19
13610	Furnizime për zyrë	19,206.24	26,338.02	7,131.78	37.13
13611	Furnizime për zyrë	4,200.00	0.00	-4,200.00	-100.00
13615	Furnizim me dokumenta bilanko	34.00	0.00	-34.00	-100.00
13615	Furnizim me ushqim për kafshë	12,941.96	7,667.23	-5,274.73	-40.76
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	28,849.79	25,385.90	-3,463.89	-12.01
13630	Furnizime mjeksore	34,029.75	7,925.92	-26,103.83	-76.71
13640	Furnizime pastrimi	14,400.67	26,953.07	12,552.40	87.17
13720	Nafte per ngrohje qendrore	469.00	0.00	-469.00	-100.00
13730	Vaj per ngrohje	6,567.00	8,121.47	1,554.47	23.67
13760	Dru	1,594.25	1,681.30	87.05	5.46
13770	Derivate per generator	18,635.17	29,669.75	11,034.58	59.21
13780	Karburant per vetura	9,050.00	0.00	-9,050.00	-100.00
13810	Pettycash	1,110.00	1,382.00	272.00	24.50
13950	Regjistrimi i automjeteve	354.54	0.00	-354.54	-100.00
13950	Regjistrimi i automjeteve-21	3,054.31	3,371.53	317.22	10.39
13951	Sigurimi i automjeteve	13,554.60	18,268.76	4,714.16	34.78
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	43,259.71	48,512.21	5,252.50	12.14
14020	Mirembajtja e ndertesave	8,192.39	23,995.26	15,802.87	192.90
14023	Mirembajtja e shkollave	33,841.27	34,461.61	620.34	1.83
14024	Mirembajtja e objekteve shendetesore	0.00	1,400.92	1,400.92	#DIV/0!
14030	Mirembajtja e auto rrugeve	67,264.69	81,842.03	14,577.34	21.67
14032	Mirembajtja e auto rrugeve lokale	0.00	577.12	577.12	#DIV/0!
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	1,672.75	1,105.13	-567.62	-33.93
14050	Mirembajtja e mobileve dhe pajisjeve	0.00	2,229.79	2,229.79	#DIV/0!
14050	Mirembajtja e mobileve dhe pajisjeve- 21	150.00	600.00	450.00	300.00
14110	Qiraja per ndertesa	100.00	437.00	337.00	337.00
14210	Reklamat dhe konkurset	2,473.20	1,770.00	-703.20	-28.43
14220	Botimet e publikimeve	0.00	1,479.00	1,479.00	#DIV/0!
14230	Shpenzimet per informim publik	1,976.50	1,101.58	-874.92	-44.27
14310	Drekat zyrtare	3,407.76	33,988.62	30,580.86	897.39
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	679,561.69	763,308.88	83,747.19	12.32
	Totali				

Paraqitja grafike e raporti për Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike Janar-Qershor 2022/2021 dhe krahasimi i tyre në përqindje.



3.5 Shërbime Komunale

Programet (drejtoritë)	Rryma (13210)		Uji (13220)		Mbeturinat (13230)		Telefon Internet 13250		Totali	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Shërbime Publike	69,114.26	76,581.35	1,253.04	1,231.76	2,304.92	2,186.89	0.00	0.00	72,672.22	80,000.00
Shëndetësia	26,070.24	22,060.60	3,504.28	4,410.10	2,103.95	2,121.42	177.40	407.87	31,855.87	28,999.99
Qendra per pune Sociale	414.58	850.00	44.87	0.00	168.32	600	106.71	290.91	734.48	1,740.91
Arsim dhe Shkencë	13,688.88	17,929.61	12,946.14	10,312.92	4,177.40	5,199.28	518.85	564.13	31,331.27	34,005.94
Totali	109,287.96	117,421.56	17,748.33	15,954.78	8,754.59	10,107.59	802.96	1,262.91	136,593.84	144,746.84

3.6 Lista e kontratave të nënshkruara

Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës (në rast anulimi data e njoftimit për anulim)	Afatet për implementimin e kontratës (shkruaj datën e fillimit dhe të përfundimit)	Data e përfundimit të kontratës (data e pranimit të përkohshëm /preliminar)	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.
NDËRTIMI I KULLËS PREJ GURIT PËR HERONJTË-OPTERUSHË-Ritenderim-ANEKS KONTRATË	11.01.2022	11.01.2022-21.01.2022	21.01.2022	9280.70		9280.70
OFRIMI I SHËRBIMEVE JURIDIKE LIGJORE PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT	28.01.2022	28.01.2022-27.07.2022	27.07.2022	50,000.00	50,000.00	
PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS-Ritenderim-LOT 1	26.01.2022	26.01.2022-25.01.2024	25.01.2024	250,000.00	119,457.60	
PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS-Ritenderim-LOT 2	26.01.2022	26.01.2022-25.01.2024	25.01.2024	250,000.00	9,655.20	
PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA HIGJENIKE TË OBJEKTEVE TË KOMUNËS-Ritenderim-LOT 3	26.01.2022	26.01.2022-25.01.2024	25.01.2024	250,000.00	117,197.76	
MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GJATË SEZONEVE DHE Mbledhja e mbeturinave-LOT 1	26.01.2022	26.01.2022-25.01.2024	25.01.2024	499,911.68	173,464.13	
MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GJATË SEZONEVE DHE Mbledhja e mbeturinave-LOT 2	26.01.2022	26.01.2022-25.01.2024	25.01.2024	499,911.68	214,503.68	
MIRËMBAJTJA E INFRASTRUKTURËS RRUGORE GJATË SEZONEVE DHE Mbledhja e mbeturinave-LOT 3	26.01.2022	26.01.2022-25.01.2024	25.01.2024	499,911.68	73,784.72	
FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80%-20%-LOT 1	22.03.2022	22.03.2022-21.03.2025	21.03.2025	850,850.00	147,825.00	
FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80%-20%-LOT 2	22.03.2022	22.03.2022-21.03.2025	21.03.2025	850,850.00	148,850.00	
FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80%-20%-LOT 3-4	22.03.2022	22.03.2022-21.03.2025	21.03.2025	850,850.00	353,100.00	
FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80%-20%-LOT 5	28.03.2022	28.03.2022-27.03.2025	27.03.2025	850,850.00	121,200.00	
FURNIZIM ME MEKANIZËM BUJQËSOR PËR FERMERË ME PARTICIPIM 80%-20%-LOT 6	22.03.2022	22.03.2022-21.03.2025	21.03.2025	850,850.00	18,940.00	
SHËRBIMET E ZHVENDOSJES ME MARIMANGË DHE BLOKIMIT TE AUTOMJETEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË RAHOVECIT	20.04.2022	20.04.2022-19.04.2024	19.04.2024	30,000.00	30,000.00	
FURNIZIMI DHE RREGULLIMI I XHAMAVE NË SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT	20.04.2022	20.04.2022-19.04.2023	19.04.2023	5,500.00	4,985.00	
FURNIZIM ME SHKUMËSA PËR SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT	20.04.2022	20.04.2022-19.05.2023	19.05.2023	4,000.00	2,177.80	

KOMUNA E RAHOVECIT DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

2022

FURNIZIM ME REKUIZITA SPORTIVE PËR SHKOLLA	29.04.2022	29.04.2022-28.04.2023	28.04.2022	22.000.00	18.214.00	
ASGJËSIMI I BARNAVE ME AFAT TË SKADUAR	12.05.2022	12.05.2022-11.05.2023	11.05.2022	21.950.00	21.880.00	
FURNIZIM ME LAPTOP PËR KUVENDIN KOMUNAL	17.05.2022	17.05.2022-26.06.2022	26.06.2022	14.500.00	12.888.00	
INSTALIMI I JASH-TËM I UJIT,RRYMËS DHE KANALIZIMIT NE QERDHEN PËR FËMIJË NE FSHATIN KRUSHË E MADHE	27.05.2022	27.05.2022-26.12.2022	26.12.2022	103,136.94	81,895.00	
NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE NE KOMUNËN E RAHOVECIT- LOT II-ANEKS KONTRATË	27.06.2022	27.06.2022-08.07.2022	08.07.2022	27,567.44		27,567.44
					1,720,017.89	36,848.14
Totali						1,756,866.03



Drejtoria për Buxhet dhe Financa :



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



Raport i punës i DKA-së në përfundimin e vitit mësimor 2021/2022

OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje

-IV- Nr. i prot. 371 Br. prot. Dt. 08.07.2022
RAHOVEC - ORAHOVAC

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal!

Në këtë raport janë pasqyruar të gjitha aktivitetet, punët dhe angazhimet e Drejtorisë Komunale për Arsim, nga 1 shtatori 2021, deri në fund të muajit qershor 2022. Këtë raport e kemi ndarë në dy periudha:

- **Periudha shtator – dhjetor (2021)**
- **Periudha janar – qershor (2022)**

Aktivitete në periudhën e parë (shtator – dhjetor)

Viti shkollor 2021/2022 do të fillonte sipas kalendarit të MASHTI-t, por, ndërkohë, me vendimin e qeverisë, fillimi i vitit të ri shkollor është shtyrë për datën 13 shtator. Në këtë periudhë është bërë edhe regjistrimi i nxënësve në klasat e dhjeta, i vlefshëm për afatin e dytë. U mbajt afati i dytë i Provimit të Maturës në dy qendra dhe morën pjesë 170 maturantë. Në oborrin e shkollës në Nagavc janë zhvilluar punimet në ndërtimin e fushës sportive. Në bashkëpunim me QKMF-në organizuam procesin e vaksinimit të punëtorëve të arsimit që nuk kishin marrë dozën e parë. Nga Forca e Sigurisë së Kosovës kemi pranuar dhuratë (donacion) mbi 10000 maska për nxënësit e shkollave të komunës sonë e poashtu jemi furnizuar edhe me 40000 maska të tjera nga Ministria e Arsimit. U mbajt dhe përfundoi trajnimi i grupit të parë të mësimdhënësve të rinjë, ndërkohë që filloi trajnimi me grupin e dytë në Shfmu “Isa Boletini”. Në shkollën “Gëzim Hamza-Piktori” u përfundua fillimi i zbatimit të projektit “Think.Design.Create”, projekt ky i fituar nga komuna jonë. Në objektin e ri të shkollës “Sadedin Hajda” ka filluar furnizimi dhe pajisja me inventar.

Pas lidhjes së kontratës, ka filluar dhe vazhduar procesi i furnizimit me lëndë djegëse (dru për ngrohje) në të gjitha shkollat që përdorin këtë lëndë djegëse. Në shkollat e reja të ndërtuara kanë përfunduar punimet, ndërkohë që punimet përfundimtare u zhvilluan edhe në 3 çerdhet e reja, në Krushë të Madhe, Xërxë dhe Ratkoc. Ka filluar të zbatohet projekti i instalimit të kamerave të sigurisë në shkolla dhe është bërë instalimi i tyre në shkollën “Rudolf Walther” në Dejnë dhe në paralelen e ndarë në Dobidol. Ka vazhduar të zbatohet projekti i instalimit të kamerave të sigurisë në shkolla, dhe ato u instaluan edhe në objektin e shkollës “Dëshmorët e Lirisë” në Pataqan të Poshtëm, në shkollën “31 Marsi” në Guri të Kuq, për të vazhduar edhe në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në Drenoc dhe në objektin e paraleles së ndarë në Senoc.

Pas lidhjes së kontratës, ka filluar dhe ka vazhduar puna në instalimin e ngrohjes qendrore në objektin e SHML “Xhelal Hajda-Toni”. Në objektin e ri të shkollës në Kaznik, është instaluar uji. Është lidhur kontrata në AQP për furnizimin e 4 objekteve të reja shkollore me inventar dhe presim që të bëhet edhe furnizimi. Ka përfunduar procesi i furnizimit me dru të shkollave që përdorin këtë lëndë djegëse.

Aktivitetet në periudhën e dytë (Janar – Qershor)

Më 10 janar ka filluar procesi mësimor i vlefshëm për periudhën e dytë të vitit shkollor në të gjitha shkollat e komunës sonë. Kemi ndërmarrë veprimet e duhura në objektin e shkollës së mesme profesionale, në mënyrë që objekti i kësaj shkolle të ngrohet në mënyrë të vazhdueshme. Në Shfmu “31 Marsi” në Guri të Kuq, janë kryer punimet e fundit të riparimit të një pjese të njeve sanitare nga kompania e kontraktuar. Kanë vazhduar punimet në projektin e instalimit të ngrohjes qendrore në objektin e SHML “Xhelal Hajda-Toni”. Kemi qenë në terren tek objekti i çerdhes për fëmijë në Krushë të Madhe së bashku me ekipin e KEDS-it, për t'i ndërmarrë veprimet e sigurimit të Pëlqimit Elektroenergjetik. Më 17 janar kemi mbajtur një takim me drejtorët e shkollave, kryetarët e Këshillave Drejtuese të Shkollave (KDSH) dhe me Koordinatorët e Cilësisë(KC) të secilës shkolle.

Nga KEDS-i, kemi marrë konfirmimin se është bërë gati Pëlqimi Elektroenergjetik (PEE) për fuqinë e angazhuar të energjisë elektrike për objektin e çerdhes dhe 2 objekteve të tjera të parashikuara të ndërtohen në të ardhmen. Kemi hapur konkursin për bursa studentore dhe menjëherë ka filluar edhe aplikimi i studentëve. Në çerdhen për fëmijë “Tulipanët” pas furnizimit me perde, u bë edhe furnizimi me tepihë për dyshe. Kemi vazhduar me organizimin dhe mbajtjen e garave shkollore të vlefshme për Olimpiadën Matematike dhe për Garën Republikane të Fizikanëve të Rinjë. Në koordinim me DKRS dhe Këshillin Organizues u kujdesëm për mbarëvajtjen e aktiviteteve të parapara për manifestimeve të Flakës së Janarit.

Kemi filluar përgatitjet për mbajtjen e Kuizit të Diturisë për lëndën e Historisë me nxënësit e klasave të 12-a, për nder të festës së 17 shkurtit. Kemi filluar me përgatitjet për hartimin e Pakos Pedagogjike për klasat 6 deri 12 dhe për këtë arsye kemi mbajtur një takim me përfaqësuesit e Aktivave Profesionale të fushave kurrikulare të shkollave. Gjatë javës së parë të shkurtit, poashtu, kemi shpërndarë lekturat dhe librat në bibliotekat e 8 shkollave të komunës sonë. Kemi riparuar pompat termike të ngrohjes qendrore në shkollën Skender Kastrati, të cilat patën një prishje, ndërsa në shkollën profesionale me ndihmën e ekipeve të KRU “Gjakova” është gjetur defekti i rrjedhjes dhe humbjeve të sasisë së ujit në rrjetin instalues. Në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në Drenoc dhe në paralelen e ndarë të saj në Senoc ka përfunduar instalimi i kamerave të sigurisë. Më 12 shkurt mbajtëm Garën Komunale të Fizikanëve të Rinj me nxënësit e klasave 9, 10, 11 dhe 12 të të gjitha shkollave. Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë organizuar dhe kanë filluar të mbahen ligjërata me karakter edukativ dhe vetëdijësues me nxënësit e disa shkollave. Për nder të 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së

Kosovës, u organizuan dhe u mbajt Kuizi i Diturisë për lëndën e Historisë me nxënësit e klasave të 12-a, dhe gara për pikturën me të mirë. Në objektin e shkollës "Tre Dëshmorët" në Vrajkë/Bratotin kanë rifilluar punimet në ndërtimin e saj dhe poashtu, punimet kanë rifilluar edhe në çerdhen e fëmijëve në Xërxë. Kemi pranuar një donacion të vogël nga OSBE për Qendrën Arsimore në shkollën "Katër Dëshmorët" në Ratkoc, ku zhvillohet mësim shtesë për fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë. U mbajt Kuvendi zgjedhor i Këshillit të Prindërve në nivel komunal, me ç'rast u zgjodh kryesia dhe kryetari. Më 19 shkurt, organizuam dhe mbajtëm Garën Komunale të Olimpiadës Matematike me nxënësit e klasave 9, 10, 11 dhe 12 të të gjitha shkollave. Më 27 shkurt, i dërguam për të marrë pjesë në Garën Republikane të Fizikanëve të Rinj 4 nxënësit fitues nga Gara Komunale të klasave 9, 10, 11 dhe 12.

U bënë përgatitjet e nevojshme dhe u mbajt manifestimi festiv për shënimin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit dhe Shkollës së parë Shqipe. Kemi përfunduar shpërndarjen e mjeteve të konkretizimit dhe pajisjeve laboratorike në 12 shkolla. Mbajtëm një takim me drejtorët e shkollave dhe me koordinatorët e cilësisë, ku u bë prezantimi i projektit "SchoolMe". Kemi bërë shkresë zyrtare në MASHT, në të cilën kemi dërguar të dhëna për çerdhet e reja dhe kemi kërkuar ndihmë për funksionalizimin e tyre me staf adekuat. Në Retijë të Poshtme ka përfunduar riparimi i kulmit të depos së druve. Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë vazhduar të mbahen ligjërata me karakter edukativ dhe vetëdijësues me nxënësit e disa shkollave. Në fillim të prillit përfundoi perioda e dytë e procesit mësimor dhe në vazhdim ishte pushimi pranveror.

Kemi filluar përgatitjet për organizimin dhe mbajtjen e Testit Ndërkombëtar PISA dhe përgatitjet për Testin e Arritshmërisë për klasat e nënta. Kemi bërë shkresë zyrtare në MASHT, me të cilën kemi kërkuar edhe njëherë që sa më shpejtë të bëhet furnizimi me inventar i shkollave dhe çerdheve të reja të ndërtuara. Ka vazhduar procesi mësimor i vlefshëm për periudhën e tretë të këtij viti shkollor, me ç'rast, nxënësit e shkollave "Bekim Sylka" dhe ata të ciklit të lartë të shkollës "Isa Boletini" kanë vazhduar të mbajnë mësim në objektin e ri të shkollës "Sadedin Hajda" dhe në objektin e Shkollës së Mesme Profesionale. Mbajtëm një takim me Kolegjiun për Arsim në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Për nder të 22 prillit – Ditës së Tokës, nxënësit dhe mësimdhënësit e të gjitha shkollave i janë bashkuar aksionit vullnetar për pastrim dhe pati një pjesëmarrje masive. DKA nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Organizatën ABSM me qendër në Zvicër dhe me degën e saj në Gjakovë, e cila funksionon si qendër edukative. Me këtë organizatë synojmë të realizojmë projekte të përbashkëta në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional. Patëm një takim edhe me përfaqësues nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar "JICA", me të cilët bashkëbiseduam për nisjen e projektit "Programi i riciklimit të mbeturinave dhe edukimi mjedisor" Ky projekt do të realizohet me nxënësit e 2 shkollave të komunës sonë.

Në paralelen e ndarë të shkollës "Rudolf Walther" në Dobidol, janë zhvilluar punime në rregullimin e kanalizimit të objektit të shkollës dhe kyçjes së tij me rrjetin kryesor të kanalizimit të fshatit. U mbajt një sesion informues për maturantët nga profesorët e Universitetit të Prizrenit lidhur me programet e studimit që ofron ky universitet.

U mbajt një takim me MASHT-in dhe u bënë përgatitjet e nevojshme për shkuarjen në ekskurzion të maturantëve. Ka vazhduar procesi mësimor i vlefshëm për periudhën e tretë të këtij viti shkollor, ndërkohë që procesi mësimor për maturantët përfundoi më 20 maj. Në objektin e vjetër të Shkollës "Isa Boletini" kanë vazhduar punimet në ndërmarrjen e masave të efijencës së energjisë, ndërkohë që këto punime kanë filluar edhe në Shkollën "Bekim Sylka".

Në MASHT kemi nënshkruar marrëveshjen për fillimin e zbatimit të projektit "EYE" për themelimin e Qendrës së Karrierës në Shkollën e Mesme Profesionale. Në shkollën Rudolf Walther në Dejnë kemi pranuar një donacion të vlefshëm nga një bashkatdhetar, në vlerë prej 8500€, ku përfshihen 10 Smart Tv, 6 fotokopjues dhe një videoprojektor. U mbajt testi PISA në 9 shkolla të komunës sonë.

Kemi aplikuar në një projekt në bashkëpunim me Caritas-in Zviceran, përmes të cilit në 3 shkolla të mesme të komunës sonë do të themelohen eko-klubet e të rinjve. Tashmë jemi përfitues të këtij projekti dhe marrëveshja do të nënshkruhet së shpejti. Mbajtmë Garën Komunale të diturisë me nxënësit e klasave të 6-a, 10-a dhe 11-a, në lëndët Gjuhë shqipe, Gjuhë angleze, Kimi, Biologji Ekologji e Mjedis. Nisëm procedurën për realizimin e projektit "Furnizimi i shkollave me teknologji informative – Tabela Digjitale".

Kanë filluar punimet në ndërtimin e fushës sportive në oborrin e shkollës "31 Marsi" në Guri të Kuq. Pas lidhjes së kontratës kanë filluar dhe po vazhdojnë punimet në instalimin e ujit, rrymës dhe kanalizimit për çerdhen e fëmijëve në Krushë të Madhe. Kemi mbajtur një takim me koordinatorët dhe administratorët e Provimit të Maturës dhe Testit të Arritshmërisë për përgatitjet që duhej bërë. Me rastin e 1 qershorit - Ditës së Fëmijëve, së bashku me DKRS-në dhe Shoqatën "Hareja" mbajtmë një manifestim festiv. Shpallëm rezultatet e përfituesve të bursave studentore

U mbajt Testi i Arritshmërisë për nxënësit e klasave të IX-ta, i cili u zhvillua në 4 qendra dhe në këtë test morën pjesë 710 nxënës. Ky test, u zhvillua në 2 pjesë, përkatësisht, më 4 qershor dhe më 14 qershor. Në SHML "Xhelal Hajda -Toni" janë zhvilluar punime në projektin e instalimit të ngrohjes qendrore. Kemi patur një takim në MASHT dhe në Departamentin e Infrastrukturës u interesuam për çështjen e projektit të shkollës në Pastasel dhe për projektin e çerdhes. Organizuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe QKMF, janë zhvilluar vizita sistematike mjekësore në shkollat fillore të komunës sonë. Më 10 qershor përfundoi mësimi për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11. U mbajt Gara Komunale e Diturisë në disa lëndë mësimore me nxënësit e klasave të katërta, të gjashta, të shtata dhe të teta. Më 18 qershor, u mbajt Provimi i Maturës, në të cilin morën pjesë 413 maturantë. Prej tyre, pragun e kalueshmërisë e arritën 280 maturantë, ose shprehur në përqindje 67,8 %, ndërsa nuk e kaluan 133 maturantë, ose shprehur në përqindje 32,2 %.



Avni Morina
Avni Morina
Drejtori i DKA-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit (KR), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Keqklasifikimi i shpenzimeve në shumën 252,910€ si pasojë e mos regjistrimit të duhur të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike përkatëse.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Rahovecit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit.
- A3 Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve.
- B1 Nënshkrimi i kontratave pa mbulueshmëri financiare.
- B2 Zotimi i mjeteve për 39 pagesa është bërë jo sipas rregullave financiare.
- B3 Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor.
- C1 Pagesa shtesë +30%, në mungesë të shtimit të numrit të të angazhuarve për 30%.
- B4 Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Rahovecit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Rahovecit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Rahovecit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë,

por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Rahovecit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Rahovecit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Procesi i raportimit në Komunë është përcjellur me mangësi, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Më tutje, pasqyrat financiare janë korrigjuar dhe dorëzuar në ZKA, përveç çështjeve të trajtuara më poshtë të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit.

Në mungesë të kontrolleve të brendshme të duhura në Komunë, janë identifikuar disa çështje të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit dhe konkluzioni i pajtueshmërisë.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, tetë (8) të përsëritura dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Neni 18, paragrafi 3, i Rregullores Financiare nr. 01/2013/MF, "Mbi shpenzimet e parasë publike", përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet ekonomike adekuate sipas Udhëzimit Administrativ për planin kontabël.

Bazuar në testet e kryera rezulton se, kishte raste të klasifikimit jo të duhur të shpenzimeve si në vijim:

- Shpenzimet për projektin "Ndërtimi dhe furnizimi me material ndërtimor për familjet skamnor", në shumën 37,163€, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të klasifikohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve;

- Shpenzimet për projektin "Ndërtimi i serave me participim", në shumën 100,000€; 41,727€; dhe 34,020€ përkatësisht, ishin regjistruar në kategorinë e investimeve kapitale në vend që të regjistrohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve; dhe

- Shpenzimet në emër të bashkëfinancimit në bujqësi me fermerët e Komunës, në shumën 40,000€, ishin regjistruar në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale në vend që të klasifikohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

Keqklasifikimet kanë ndodhur për shkak të planifikimit dhe buxhetimit jo

adekuat të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike.

Ndikimi Klasifikimet ekonomike jo të sakta prezantojnë pamje jo të drejtë të shpenzimeve të pasqyrave financiare, duke mbivlerësuar/ nënvlerësuar kategorinë ekonomike të shpenzimit, si dhe nuk pasqyrojnë drejtë informacionet për kategoritë përkatëse të shpenzimeve.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë, që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planfikohen në ndarjet/ kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ri destinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Përdorimi jo adekuat i procedurës së prokurimit

Gjetja	Sipas Ligjit të Prokurimit Publik, neni 32.1, për një aktiviteti të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të shfrytëzojë procedurën e hapur ose procedurën e kufizuar. Nëse një dispozitë e neneve 34-37 të këtij ligji shprehimisht autorizon shfrytëzimin e një procedure tjetër prokurimi, autoriteti kontraktues mund të shfrytëzojë atë procedurë ose procedurën e hapur. Ushtrimi i një procedurë të prokurimit duhet të bëhet në pajtim të plotë me dispozitat e zbatueshme të këtij ligji. Kontrata "Pastrimi dhe mirëmbajtja hixhienike e objekteve të komunës së Rahovecit", me vlerë 50,000€, është kontraktuar përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me ftesë të një operatori ekonomik duke u thirrur në nenin 35 paragrafin 2.1 të LPP-së, ndërsa do të duhej të realizohet përmes procesit të rregullt të prokurimit më procedurë të hapur. Sipas zyrtarëve të Komunës kjo ka ndodhur si pasojë e vonesës në iniciimin e aktivitetit të rregullt të prokurimit.
Ndikimi	Përdorimi i procedurës së negociuar, pa publikim të njoftimit për kontratë, lë hapsirë të kufizimit të konkurrencës në rastet kur shërbimin mund ta ofertojnë shumë operator ekonomik.
Rekomandimi A2	Kryetari duhet të sigurojë, që iniciimi i aktiviteteteve të prokurimit bëhet në kohë dhe përdorim të duhur të procedurave të prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve

Gjetja	Komuna kishte bërë thirrje publike për subvencionim të sportit, në të cilën janë përcaktuar kriteret që duhet t'i plotësojnë përfituesit e subvencioneve. Një ndër kriteret e përcaktuara në thirrjen publike ishte, që aplikuesit të ofrojnë vërtetimin tatimor si dëshmi që nuk ka obligime tatimore ndaj Administratës Tatimore. Bazuar në testet e kryera rezulton se, tre OJQ-të fituese të subvencioneve janë përzgjedhur pa i plotësuar dokumentacionet e kërkuara në thirrjen publike, të cilat kishin dorëzuar vërtetime jo valide, si dëshmi për shlyerjen e borxheve ndaj ATK-së. Dokumentet në fjalë nuk kishin rezultuar nga sistemi i ATK-së. Shumat vjetore të këtyre tre përfituesve të subvencioneve në total janë 72,600€. Sipas zyrtarëve të Komunës kjo kishte ndodhur, sepse komisioni për vlerësim të dokumenteve të aplikuesve për përfituesit e subvencioneve të sportit, nuk kishte vërtetuar vlefshmërinë e vërtetimit tatimor.
Ndikimi	Përzgjedhja e përfituesve nga Komisioni vlerësues, pa u përmbushur

kriteret e parapara në thirrjen publike, paraqet dëmtim të buxhetit dhe jo transparencë publike.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë, që Komisioni për vlerësim të aplikacioneve dhe përzgjedhje të përfituesve të subvencioneve të sportit, të zbatojë të gjitha kriteret e parapara në thirrjen publike dhe në asnjë rast mos të tejkalohet pa u vërtetuar se dëshmitë janë valide me theks të veçantë të vërtetimit për shlyerjen e borxheve ndaj Administratës Tatimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Nënshkrimi i kontratave pa mbulueshmëri financiare

Gjetja Neni 13.8, i Ligjit nr. 07/L-41 për ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2021, parasheh që nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga organizatat buxhetore, vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara me ligjin e buxhetit për vitin aktual dhe për dy vite në vijim.

Në dy raste ishin nënshkruar kontrata për projekte kapitale deri sa nuk kanë pasur mbulueshmëri financiare si:

- Për projektin "Ndërtimi i AMF-së në lagjën e epërme", me ligjin e buxhetit aktual dhe dy vitet pasuese ishin paraparë 150,000€, ndërsa kontrata e nënshkruar ishte në vlerë 252,269€ apo 102,269€ më e lartë se vlera e planifikuar; dhe

- Për projektin "Ndërtimi i kanalit të kullimit tokave në Fortesë-Celinë", me ligjin e buxhetit për vitin aktual dhe dy vitet pasuese janë paraparë 220,000€, ndërsa kontrata e nënshkruar ishte në vlerë 239,520€, apo 19,520€ më e lartë se vlera e planifikuar.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

Ndikimi Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, dhe nënshkrimi i kontratave për tej limiteve buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare të Komunës duke qenë se duhet të bëhen shumë përshtatje buxhetore dhe ri destinime të mjeteve për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve. Kjo pamundëson realizimin e projekteve tjera të parapara të realizohen nga mjetet e ri destinuara.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se do të aplikoj ligjin e prokurimit - të inicioj një aktivitet prokurimi vetëm pasi që të ketë kryer një vlerësim formal të nevojave dhe të nënshkruaj një kontratë për projekte kapitale në rastet kur shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim, apo mundësisë së ridestinitimit të mjeteve për projektet kapitale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Zotimi i mjeteve jo sipas rregullave financiare

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013, në nenin 12, përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër- blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimi të faturës të ekzekutohet pagesa.

Bazuar në testet e kryera rezulton se, për 39 pagesa me vlerë 2,032,699€, fillimisht ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja.

Shkaku i një dukurie të tillë është planifikimi jo adekuat i buxhetit dhe inicimi i procedurave duke shpërfillur zbatimin e rregullave në fuqi.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme ndikon në krijimin e obligimeve të cilat e rëndojnë buxhetin e vitit pasues.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi, sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/ shërbimi dhe të kryhet pagesa.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Mos pagesa e faturave brenda afatit ligjor.**

Gjetja Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, në nenin 39.1, parasheh që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve, kemi vërejtur se gjatë vitit 2021 ishin kryer pagesa në shumën 2,523,472€ apo 1,165 raste të pagesave nga lista e furnitorëve, të cilët e kishin tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh deri në dy vite.

Hyrja në obligime pa buxhet dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës ka ndikuar në mos realizimin e pagesave brenda afatit kohor ligjor, që kanë rezultuar dhe mund të ndikojnë në shtimin e numrit të realizimit të pagesave përmes vendimeve gjyqësore/ përmbarimore.

Ndikimi Si pasojë e vonesave të pagesave dhe mungesës së informacioneve të plota, mund të dobësohet aftësia e Komunës për të parashikuar dhe menaxhuar nevojat për likuiditet. Po ashtu, Komuna mund të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbarimore.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave, për të siguruar që Komuna mos të hyjë në obligime pa fonde të mjaftueshme dhe që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Pagesa shtesë +30%, në mungesë të shtimit të pozicionit/ artikullit**Gjetja**

Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, në nenin 56.10, ndër të tjera përcakton mospërputhjet e lejuara në rastin e Kontratave Publike Kornizë, që janë +/- 30% edhe për pozicione apo artikull.

Kontrata kornizë "Shërbime për realizimin e vitalizimit të infrastrukturës për funksionalizimin e projektit – shtretër shtëpiak", në shumën 378,000€, parasheh angazhimin e 53 punonjësve për realizimin e këtij projekti. Përveç kësaj, Kontrata përmban edhe +/- 30% si devijim të lejuar të shumës së Kontratës.

Për tre pagesa të testuara për muajt prill, qershor dhe gusht pagesat e faturave përmbledhëse për secilin muaj ishin 20,475€, shumë kjo e cila përmbanë + 30% e lejuar shtesë për muaj. Por, shtesa e lejuar financiare nënkupton edhe shtimin e pozicionit ose artikullit, e që në rastin konkret është numri i punonjësve nga 53 në 69 punonjës.

Mirëpo, sipas raporteve të pranimit nga lista e të angazhuarve të hartuara nga Komisioni i pranimit, shihet se krahas shtimit të vlerës financiare nuk është bërë edhe rritja e numrit të punonjësve:

- Për muajin prill janë angazhuar 61 punonjës, mirëpo nuk janë angazhuar edhe tetë punonjës (katër mjekë dhe katër infermier), ku vlera financiare sipas specifikave të kontratës për këta punonjës të pa angazhuar është 2,420€;

- Për muajin qershor janë angazhuar 62 punonjës, mirëpo nuk janë angazhuar edhe shtatë punonjës (katër mjekë dhe tre infermier), ku vlera financiare sipas specifikave të kontratës për këta punonjës të pa angazhuar është 2,200€;

- Për muajin gusht janë angazhuar 61 punonjës, mirëpo nuk janë angazhuar edhe tetë punonjës (katër mjekë dhe katër infermier), ku vlera financiare sipas specifikave të kontratës për këta punonjës të pa angazhuar është 2,420€.

Për shkak të mosfunksionit adekuat të kontrolleve, faturimi ishte bërë në formë të përmbledhur pa u bashkangjitur specifikimet e pozicioneve të kontraktuara.

Ndikimi

Pagesa dhe faturimi përmbledhës pa ju bashkangjitur specifikacioni i pozicioneve të kryera, rritë rrezikun e pagesave për punë/ shërbime të pa kryera dhe njëherësh ndikon në dëmtimin e buxhetit.

